



Mbrojtja

Viti i 87-të i botimit
Tetor 2019 / Nr. 10



Misioni i NATO-s në Irak
Vendet e Kartës së
Adriatikut mbështesin
nismën e Shqipërisë



Gjeneral Brigade Kollçaku vizitë në Greqi
Do të rritet e
thellohet bashkëpunimi
në fushën e mbrojtjes



Aleanca
Në Bazën Ajrore Farkë
trajnim ndërkombëtar
për pilotët



Shqipëria merr drejtimin e SEDM
Xhaçka: Dyer të hapura
për një rajon më të sigurt

Përmbajtja

Numri 10

SHBA-A5

- 6** Xhaçka: Të jesh anëtar i NATO-s është mbi të gjitha përgjegjësi

INTEGRIMI

- 8** Leyla Moses-Ones: "SHBA mbështetin Forcat e Armatosura Shqiptare"

GJENERAL BRIGADE KOLLÇAKU NË GREQI

- 12** Do të rritet e thellohet bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes

MBROJTJA CIVILE

- 18** BE: Angazhim për pasojat e tërmetit, ndihma dhe asistencë

ARSIMIMI USHTARAK

- 20** Akademia e FA do akreditohet si institucion i arsimit të lartë

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Saimir ALIJA

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ



4 SEDM

Xhaçka: Dyer të hapura për një rajon më të sigurt

Ministria e Mbrojtjes ka marrë drejtimin e disa nismave të rëndësishme për rajonin mes të cilave dhe Ministerialin e nismës SHBA-Karta e Adriatikut...



5 MISIONI I NATO-s NË IRAK

Vendet e Kartës së Adriatikut mbështetin nismën e Shqipërisë

Shqipëria bëhet sërish promovuese dhe mbështetëse e paqes dhe sigurisë, duke i propozuar vendeve të Kartës së Adriatikut, SHBA- A5, kontribut të përbashkët...



10 20 VJETORI I SEEBRIG

Shqipëria merr kryesimin e sekretariatit të SEDM

Më 30 gusht në kazermat në Tirnavos-Larissa, Greqi, u mbajt një ceremoni për të shënuar 20 vjetorin e krijimit të Brigadës SEEBRIG (Brigada e Evropës...



48 REFLEKSION PËR 88 VITE AKTIVITET

Shtëpia e ushtarakëve në vite

Shtëpia e Ushtarakëve është e lidhur ngushtësisht me ndryshimet dhe zhvillimet e Forcave të Armatosura. Fillesat e këtij institucioni i gjejmë me miratimin e dekretligjit të rregullimit ...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 87-të i botimit
Nr. 10/2019

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfutimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





SHQIPËRIA MERR DREJTIMIN E SEDM



Xhaçka: Dyer të hapura për një rajon më të sigurt

Pak ditë pas zyrtarizimit të drejtimit nga Shqipëria të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM), në Tiranë u mbajt e martën, më 17 shtator, mbledhja e parë e Komitetit Drejtues Politik-Usharak, ku mori pjesë edhe ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka. Në fjalën e saj përpara përfaqësuesve të lartë të këtij Ministeriali, ministrja Xhaçka theksoi rëndësinë e zgjerimit të nismave rajonale me anëtarë të rinj.

“Politika e dyerve të hapura do t’i japë një frymëmarrje të re nismave rajonale. Zhvillimet në Ballkanin Perëndimor janë tregues i mirë se si ky bashkëpunim, me përfshirjen e NATO dhe Bashkimit Europian mund të ndikojë në stabilitetin dhe ndërtimin e shoqërive moderne e paqësore.”

Ministrja e Mbrojtjes nënvizoi rolin e Shqipërisë në integrimin euroatlantik të vendeve të rajonit, si faktor kyç në zgjerimin e hartës së anëtarësimit për vendet e Ballkanit

Perëndimor dhe një zë i fortë për sigurinë dhe stabilitetin në këto vende. Krahas SEDM, gjatë vitit 2019, Shqipëria përmes Ministrisë së Mbrojtjes ka marrë drejtimin e disa nismave të rëndësishme për rajonin mes të cilave dhe Ministerialin e nismës SHBA-Karta e Adriatikut apo siç njihet ndryshe A-5.

Ceremonia e Transferimit të Presidencës SEDM nga Greqia në Shqipëri, ku ishte i pranishëm z. Petro Koçi, zëvendësministër i Ministrisë së Mbrojtjes, u zhvillua

- Ministria e Mbrojtjes ka marrë drejtimin e disa nismave të rëndësishme për rajonin mes të cilave dhe Ministerialin e nismës SHBA-Karta e Adriatikut apo siç njihet ndryshe A-5.

më 30 gusht 2019, në kazemat e Tirnavos-Larissa, Greqi. "Si kryetar i Procesit SEDM deri në korrik 2021, dëshiroj t'ju siguroj të gjithë ju që stafi i Sekretariatit të Kryesisë shqiptare dhe unë vetë do të punojmë së bashku me vendet anëtare të nismës për ta bërë SEDM më të rëndësishme për sfidat e sigurisë së rajoni ynë, i dobishëm dhe efektiv në forcimin e stabilitetit rajonal në rajonin tone", theksoi Koci.

Kryesimi i procesit të SEDM është me rotacione dyvjeçar midis vendeve antare. Për periudhën 2017-2019, Sekretariati i SEDM është drejtuar nga Greqia, konkretisht nga Ambasadori Z. Eleftherios Anghelopoulos.

Bullgaria ka qënë vendi i parë pritës për selinë shumëkombëshe, e cila ishte vendosur në Plovdiv. Procesi filloi në shtator 1998 me nënshkrimin e një marrëveshjeje korvizë për krijimin e një Forcë paqeruajtjeje Shumëkombëshe në Evropën Juglindore. Kjo iniciativë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e besimit midis vendeve të Ballkanit, ndërveprimin e tyre dhe integrimin në strukturat Euro-Atlantike, si dhe në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit rajonal. Në këtë proces marrin pjesë anëtarë si: Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Italia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Sllovenia, Serbia, Turqia, Ukraina dhe SHBA dhe me statusin e vëzhguesit janë Moldavia dhe Gjeorgjia. Delegacionet e vendeve anëtare të Sekretariatit të SEDM-it takohen rregullisht dy herë në vit, në vendin ku aktualisht drejtohet sekretariati.

MISIONI I NATO-s NË IRAK

Vendet e Kartës së Adriatikut mbështesin nismën e Shqipërisë

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi do të jenë pjesë e misionit të NATO në Irak

Shqipëria bëhet sërish promovuese dhe mbështetëse e paqes dhe sigurisë, duke i propozuar vendeve të Kartës së Adriatikut, SHBA- A5, kontribut të përbashkët në misionin e NATO në Irak. Pak muaj pas marrjes së kryesimit të Kartës së Adriatikut nga Shqipëria, shefat e shtabeve të përgjithshëm të Forcave të Armatosura të A-5 u mbledhën në vendin tonë në konferencën e posaçme, ku u mbështet propozimi që Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi të jenë pjesë e misionit të NATO në Irak. Konferencën, ku morri pjesë edhe zëvendëskomandanti i Forcave Amerikane në Evropë (EUCOM), gjenerallejtant Stephen Twitty, e përshëndeti edhe ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila nënvizoi intensifikimin gjatë dy viteve të fundit të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fushën e Mbrojtjes. Ministria Xhaçka theksoi edhe një herë qëndrimin e vendit tonë për politikën e dyerve të hapura edhe për Kartën e Adriatikut.

"Është më e rëndësishme se kurrë që dyert e kësaj nisme të vazhdojnë të mbeten të hapura. A-5 duhet të behet sa me shpejt A-6 pse jo, edhe A-7. Unë besoj se ajo do të ishte një ditë e mirë për sigurinë e rajonit, por edhe një lajm shumë i mirë për sigurinë e gjithë Evropës."

Duke e vlerësuar Kartën e Adriatikut si një udhërrëfyes për anëtarësimin në NATO, ministria Xhaçka u ndal edhe te detyrimet që këto vende kanë si anëtare të Aleancës. "Të jesh anëtar i NATO-s është mbi të gjitha një përgjegjësi. Një përgjegjësi për të përfaqësuar vlerat mbi të cilat është ngritur Aleanca, për të bashkëpunuar për konsolidimin e sigurisë e stabilitetit të rajonit tonë, por edhe për të kontribuar për sigurinë tonë kolektive kudo që të jetë nevoja. Prandaj, unë dua t'ju propozoj sot, që të diskutojmë dhe të miratojmë propozimin tonë për një përfaqësim të përbashkët për vendet e A-5 në misionin e NATO-s në Irak.", - tha në fjalën e saj ministria e Mbrojtjes.

Në konferencë, mori pjesë edhe Republika e Kosovës me statusin e vëzhguesit dhe si vend që ka aplikuar për t'u anëtarësuar. Në përfundim, shefat e shtabeve të A-5 dolën me një deklaratë të përbashkët ku mbështetën propozimin e Shqipërisë që vendet anëtare të Kartës së Adriatikut të marrin pjesë në misionin e NATO në Irak, duke ia deleguar këtë propozim Ministerialit të A-5, i cili do të mbahet në Tiranë në dhjetor të këtij viti.



Dua t'i uroj në mënyrë të veçantë mirëseardhjen zëvendëskomandantit të Komandës së Shteteve të Bashkuara në Europë, Lieutenant General Twitty. Dua t'i uroj në mënyrë të veçantë mirëseardhjen zëvendëskomandantit të Komandës së Shteteve të Bashkuara në Europë, Lieutenant General Twitty.

I dashur Gjeneral, 2018 dhe 2019 kanë qenë dy vite që kanë parë një intensifikim të jashtëzakonshëm të bashkëpunimit mes Forcave të Armatosura të vendeve tona, por edhe një intensifikim të jashtëzakonshëm të mbështetjes së Shteteve të Bashkuara për Shqipërinë. Falë mbështetjes suaj, Shqipëria ka arritur të bëjë një progres shumë të madh drejt modernizimit të Forcave të saj të Armatosura, por edhe drejt përmbushjes së objektivit tonë madhor për t'u shndërruar në një forcë vullnetare, profesioniste dhe moderne të standardeve më të mira që i takon aleancës tonë NATO.

Në emër të qeverisë shqiptare, por edhe të popullit shqiptar, më lejoni Gjeneral që t'ju shpreh mirënjohjen tonë më të sinqertë edhe më të thellë për Shtetet e Bashkuara dhe për taksapaguesit amerikanë për ndihmën e tyre bujare. Por një falënderim e kam padyshim edhe për Komandën Amerikane në Europë me të cilën kemi pasur një bashkëpunim jashtëzakonisht efikas edhe të frytshëm.

Të dashur miq, mjafton të shohësh se çfarë trajktore ka ndjekur procesi i integritimit të vendeve tona që nga momenti i përfshirjes në Kartën e Adriatikut për të kuptuar sesa e suksesshme ka qenë kjo nismë.

Shqipëria, që iu bashkua Kartës së Adriatikut, 17 vite më parë, ishte një vend shumë ndryshe nga ai që është sot. Dhe nuk ka asnjë dyshim, që nëse sot ne jemi anëtarë të NATO dhe, nëse sot, kemi dhënë prova që e meritojmë anëtarësimin, kjo i detyrohet në një masë të madhe edhe kësaj nisme, bashkëpunimit dhe shkëmbimit që kemi pasur mes

Të jesh anëtar i NATO-s është mbi të gjitha përgjegjësi

Fjala e plotë e ministrit të Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka, në Konferencën e CHOD të vendeve të Kartës së Adriatikut, SHBA-A5, mbajtur në Durrës, 25 shtator 2019

nesh, e sigurisht, mbështetjes e udhëheqjes së aleatëve tanë më të mirë, ata amerikanë.

Sot, Shqipëria është një shtyllë stabiliteti në rajon dhe një eksportuese neto e sigurisë, që i është bashkuar shumë prej misionëve të Aleancës dhe ka dhënë kontributin e saj kudo që ka qenë e nevojshme. Jemi, në fakt, kontribuesit e dytë më të mëdhenj për frymë pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por sigurisht, ashtu si procesi i integritimit në NATO, edhe Karta e Adriatikut ka pasur një efekt dhe një ndikim që ka shkuar shumë përtej sektorit ushtarak, sepse ka shërbyer si nxitëse e një sërë reformash të tjera shtetformuese e modernizuese.

Natyrisht, zhvillimet që kanë përjetuar vendet tona gjatë kësaj periudhe nuk janë identike. Por trajektorja që ka ndjekur Shqipëria nuk ka qenë krejt unike. Në një masë të madhe është ajo që ka ndodhur edhe me vendet e tjera të rajonit ku dëshira për t'iu bashkuar Aleancës më të madhe ushtarake që ka njohur historia dhe, vetëdija për transformimin që kërkohej për të realizuar këtë objektiv, kanë vënë në lëvizje një proces të gjerë reformimi e modernizimi. Dhe ajo çka sigurisht askush nuk mund ta mohojë, është që mbarë rajoni ynë, që vetëm disa dekada më parë ishte arenë konflikti dhe lufte, është sot në paqe, është më i sigurt e me më shumë stabilitet se në çdo



moment të historisë së tij.

Është kjo analizë e impaktit që ka pasur Karta e Adriatikut në dinamikën e brendshme, por edhe në ato rajonale, arsyeja përse unë besoj që, sot, është më e rëndësishme se kurrë, që dyert e kësaj nisme të jenë të hapura dhe të vazhdojnë të jenë të hapura për çdo vend tjetër të rajonit. Nuk do të kisha asnjë problem që t'i shmangesha edhe emrave konkretë, por nuk besoj se është ai qëllimi. Qëllimi është që dyert të mbeten të hapura për vendet e tjera që shumë shpejt, më vonë, më shpejt se sa vonë, të kishim mundësi që A5 ta shikonin A6 pse jo një A7.

Unë besoj që kjo do të ishte një ditë jashtëzakonisht e mirë për rajonin, pra zgjerimi i A5, por edhe një ditë shumë e mirë për të gjithë Europën. Le të mos kemi asnjë iluzion. Pavarësisht asaj që është arritur, rajoni i Ballkanit Perëndimor është ende sot arenë e një përplasjeje interesash gjeo-strategjike, që herë pas here ka arritur deri në ekstrem me agresivitetin e tij dhe strategjitë hibride që janë vënë në përdorim. Por unë nuk kam asnjë dyshim, që anëtarësimi i plotë në strukturat euroatlantike është jo thjesht mënyra më e mirë, por është mënyra e vetme, për të forcuar imunitetin tonë ndaj të gjitha këtyre ndërhyrjeve. Të jesh anëtar i NATO është sigurisht një privilegj. Është një pozicion nga i cili çdonjëri nga vendet tona ka përfituar jashtëzakonisht shumë. Por të jesh anëtar i NATO është mbi të gjitha një përgjegjësi. Një përgjegjësi për të përqaftuar vlerat mbi të cilat është ngritur Aleanca jonë, për të bashkëpunuar për konsolidimin e sigurisë dhe stabilitetin e rajonit tonë, por edhe për të kontribuar për sigurinë tonë kolektive kudo ku lypset nevoja.

Prandaj, unë dua t'ju përgëzoj sot për këtë takim dhe dua t'ju propozoj që të diskutojmë dhe të miratojmë në përfundim të kësaj konference propozimin tonë për një përfaqësim të përbashkët për vendet e A-5 në misionin e NATO në Irak. Duke uruar që ky propozim do të gjejë mbështetjen tuaj, dua t'ju uroj edhe njëherë të gjithëve një konferencë sa më të suksesshme.

INICIATIVA US-ADRIATIC CHARTER (A-5)

Konferenca e 23-të e shefave të Shtabit të Përgjithshëm

Morën pjesë shefat e shtabeve të FA të vendeve anëtare të US-A5; Shqipëria, Bosnja Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, si dhe Komandanti i FSK dhe Zv/Shefi i Shtabit të FA të Sllovenisë në statusin e vendit vëzhgues

Në qytetin e Durrësit, në datat 25 shtator 2019 u zhvillua Konferenca e 23-të e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të iniciativës US-Adriatic Charter (A-5). Konferenca e A5 është aktiviteti më i rëndësishëm që zhvillojnë Forcat e Armatosura në kuadër të kësaj iniciative. Ajo përfshin organizimin dhe realizimin e një sërë aktivitetesh rajonale dhe me NATO-n. Organizimit të kësaj konference i paraprinë një sërë aktivitetesh të tjera që përfshijnë takimin e tretë të grupit të punës (IWG) si dhe takimin e N/oficerëve të SHSHP (CSEL). Takimi i tretë i grupit të punës (IWG) u bashkëdrejtua nga Kolonel Bilbil Bitri, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes, SHPFA dhe N/kolonel LTC Aimee J. Mowry, përfaqësuese e US EUCOM. Takimi i N/oficerëve të SHSHP (CSEL) u bashkëdrejtua nga Kapter Emiljan Dama, N/oficer i SHSHPFA dhe Krye Kapter Phillip EASTON, N/oficer i US EUCOM, takime të cilat u zhvilluan në datë 24 shtator 2019. Këto aktivitete i paraprinë dhe krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin e Konferencës së Shefave të Shtabit US-Adriatic Charter. Në rolin e vendit organizator, Konferenca e 23-të e Shefave të Shtabit u bashkëdrejtua nga Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku dhe Zv/komandanti i US EUCOM Gjeneral lejtant Stephen M. Twitty

Në aktivitetin morën pjesë shefat e shtabeve të FA dhe N/oficerët e SHSHP të vendeve anëtare të US-A5; Bosnja Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, si dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Zv/Shefi i Shtabit të FA të Sllovenisë në statusin e vendit vëzhgues. Pjesë e kësaj konference ishin gjithashtu komandantët e gardave kombëtare të SHBA-New Jersey, Maryland, Minnesota, Vermont, Maine, Ohio, Colorado dhe Iowa, atashë ushtarakë të vendeve respektive, përfaqësues të US EUCOM, SHPFA dhe vendeve anëtare të US-Adriatic Charter.

Konferencën e pershendeti Ministri i Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka e cila ndër të tjera u shpreh se A5 është histori suksesi për bashkëpunimin rajonal dhe për integrimin Euro-Atlantik. Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, SHSHPFA dhe Gjenerallejtenant Stephen M. Twitty ju drejtuan me një fjalë të vecantë hapje konferencës për të vazhduar më pas sipas agjendës.

Pjesëmarrësit në konferencë u informuan përmes Raportit Vjetor për realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe atyre të koordinuara mes paleve gjate vitit. Në emër të Grupit të Koordinimit, përfaqësuesi i vendit tonë N/kolonel Fredi Maksuti prezantoi në detaje aktivitetet e zhvilluara në kuadër të A-5, nën drejtimin e vendit tonë, të cilat përfshijnë takimet e Drejtorive të J-2, J-3/7, J-4, J-6 dhe N/oficerëve të SHSHP të vendeve të A5, kontributin e kësaj iniciative në operacionet e drejtuara nga NATO, kurset, trajnimet dhe stërvitjet, cikël i cili për vitin 2019 mbyllet me stërvitjen Joint Reaction 2019 e cila zhvillohet në vendin tonë në muajin tetor 2019. Më pas, vendet pjesëmarrëse prezantuan këndvështrimet e tyre në temën "Enhancing NATO Interoperability and Readiness to Face Common Security Threats and Challenges". Vendi ynë në këtë konferencë, propozoi mundësinë e kontibuteve të përbashkëta në misionet e ardhshme të NATO-s, propozim i cili u vlerësua nga pjesëmarrësit dhe u dakordësua që të behet pjesë e takimit të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të A-5, në muajin dhjetor të këtij viti.





Shqipëria ka respektuar zotimet e Samitit të Wellsit

Leyla Moses-Ones: “SHBA mbështesin Forcat e Armatosura Shqiptare”

Miliona dollarë investime dhe qindra projekte, që kanë modernizuar ndjeshëm Forcat e Armatosura shqiptare duke kulmuar me Bazën e ardhshme Ajrore të NATO në Kuçovë. Kjo është vëmendja që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë treguar për Shqipërinë, vëmendje e cila në dy vitet e fun-

dit ka shënuar një nivel shumë domethënës. Në shenjë vlerësimi për kontributin e SHBA në fushën e Sigurisë e Mbrojtjes në Shqipëri, në një ceremoni ku morri pjesë edhe e dërguara me punë e SHBA, Leyla Moses-Ones, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, nderoi me Medaljen e Mirënjohjes, Zyrën e Atasheut Ushtarak të SHBA në Tiranë dhe Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak në Tiranë.

“Siç kam pasur rastin ta bisedoj gjatë të dy vizitave që kam zhvilluar me homologët e mi në Pentagon, në terma të kontributit për frymë, Shqipëria renditet e dyta pas SHBA. Vitet 2018 dhe 2019 shënuan një periudhë jashtëzakonisht të suksesshme për këtë bashkëpunim, sepse investimet e SHBA në fushën e Mbrojtjes në Shqipëri nuk kanë njohur asnjëherë një vëmendje më



“Shtetet e Bashkuara mbështesin Forcat e Armatosura shqiptare sepse kanë treguar pafundësisht ndër vite, se janë të gatshme, të përgatitura dhe të afta të luftojnë krah për krah me trupat amerikane dhe ato të NATO, kudo, në çdo kohë dhe në çfarëdo kushte”.

në mbështetje të aspiratës së shqiptarëve për të ndërtuar një shtet e një shoqëri evropiane, të bazuar tek sundimi i ligjit dhe vlerat e parimet e demokracisë”, - nënvizoi ministrja e Mbrojtjes.

Sipas ministres Xhaçka, ashtu siç kanë treguar gjatë këtyre viteve se dinë të jenë partnerë të përgjegjshëm dhe besnikë, të vendosur për të përmbushur detyrimet e pritshmëritë që kanë aleatët, po njësoj FA do të vazhdojmë edhe në të ardhmen të japin kontributin e tyre në çdo mision, apo situatë ku do të jetë e nevojshme për të garantuar sigurinë e SHBA, Aleancës dhe rajonit.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas të ngarkuarës me punë Leyla Moses – Ones, përgëzojnë Shqipërinë për angazhimin e saj për bashkëndarjen e barrës për NATO dhe mbështet përpjekjet e saj të vazhdueshme deri në vitin 2024.

“Shtetet e Bashkuara mbështesin Forcat e Armatosura shqiptare sepse kanë treguar pafundësisht ndër vite, se janë të gatshme, të përgatitura dhe të afta të luftojnë krah për krah me trupat amerikane dhe ato të NATO, kudo, në çdo kohë dhe në çfarëdo kushte. Për më tepër, Shqipëria ka respektuar zotimet e Samitit të Wellsit dhe vazhdon të rrisë shpenzimet për Mbrojtjen kombëtare drejt qëllimit të 2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto”, u shpreh e ngarkuara me punë e SHBA. Kontributi i SHBA në fushën e Mbrojtjes e Sigurisë në Shqipëri, shtrihet që nga automjetet e blinduara për Grup Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë, Qendra për Reagimin Kibernetik, trajnimi dhe arsimimi i efektivëve, pajisja e Forcës Ajrore me helikopterë “Black Hawk”, projektet në sistemin e ndërlihdhjes, apo pajisjet me vlerë 1 milion dollarë për përgjigjet ndaj përmbytjeve dhe më shumë se 800 mijë dollarë ndihmë humanitare çdo vit.



“Medalja e Mirënjohjes”, për Zyrën e Atasheut Ushtarak të SHBA dhe Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak amerikan në Tiranë.

të madhe. Forcat tona të Armatosura janë duke u shndërruar sot në një forcë ushtarake moderne, me një nivel profesionalizmi që i lejon të marrë pjesë në misionet e NATO krah për krah me kolegët tanë amerikanë e evropianë”, - u shpreh ministrja e Mbrojtjes.

Ajo nënvizoi kontributin e SHBA në reformën në drejtësi. “Sot, kur

falë mbështetjes së vendosur e të pakursyer të partnerëve tanë amerikanë, Shqipëria po hyn në fazën më jetike të zbatimit të reformës në drejtësi, është fare e qartë për çdo qytetar shqiptar sesa e rëndësishme është kjo mbështetje dhe çfarë roli vendimtar kanë luajtur e vazhdojnë të luajnë Shtetet e Bashkuara

Shënohet 20 vjetori i themelimit të SEEBRIG

Shqipëria merr kryesimin e sekretariatit të SEDM

Më 30 gusht në kazemat në Tirnavos-Larissa, Greqi, u mbajt një ceremoni për të shënuar 20 vjetorin e krijimit të Brigadës SEEBRIG (Brigada e Evropës Juglindore). Në këtë aktivitet të rëndësishëm ishte i pranishëm z. Petro Koçi, zëvendësministër i Ministrisë së Mbrojtjes.

Në të njëjtën ceremoni, u mbajt gjithashtu Ceremonia e Transferimit të Presidencës SEDM nga Greqia në Shqipëri. Detyra u dorëzua nga Sekretariati i Athinës i kryesuar nga Ambasadori Eleftherios Angelopoulos, dhe u pranua nga Sekretariati i Tiranës, i cili do të kryesohet nga Petro Koçi, zëvendësministri i Ministrisë së Mbrojtjes, për dy vitet e ardhshme 2019-2021. Shqipëria ka marrë, për një periudhë dy vjeçare, kryesimin e Sekretariatit të iniciativës më të madhe rajonale, Ministeriali i Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore, SEDM (South Eastern Defense Ministerial). Sekretariati i SEDM është mbajtur nga Greqia për periudhën 2017-2019.

Në këtë ceremoni ka përshëndetur z. Petro Koci, si përfaqësues i vendit pritës të njësisë së Ushtrisë që ofron mbështetje për Shtabin e SEEBRIG, Komandanti aktual i SEEBRIG, Komandanti SEDM, etj. "Si kryetar i Procesit SEDM deri në korrik 2021, dëshiroj t'ju siguroj të gjithë ju që stafi i Sekretariatit të Kryesisë shqiptare dhe unë vetë do të punojmë së bashku me vendet



Petro Koci: "Si kryetar i Procesit SEDM deri në korrik 2021, dëshiroj t'ju siguroj të gjithë ju që stafi i Sekretariatit të Kryesisë shqiptare dhe unë vetë do të punojmë së bashku me vendet anëtare të nismës për ta bërë SEDM më të rëndësishme në forcimin e stabilitetit rajonal në rajonin tone".



anëtare të nismës për ta bërë SEDM më të rëndësishme për sfidat e sigurisë së rajoni ynë, i dobishëm dhe efektiv në forcimin e stabilitetit rajonal në rajonin tone", theksoi Koci.

"Pas më shumë se njëzet viteve,

tha Koçi, të historisë së SEDM, ajo ka dëshmuar vlefshmërinë e shërbimit si një mekanizëm i shkëlqyer për ndërtimin e besimit; forcimi i bashkëpunimit ushtarak në Evropën Jug-Lindore; sigurimi i mjedisit të

Drejtorët e Zbulimit të Kartës së Adriatikut A-5 në Tiranë

nevojshëm për bashkëveprim dhe bashkëpunim midis ushtarakëve tanë; duke rritur nivelin e bashkëveprimit me organizatat e tjera ndërkombëtare, përkatësisht NATO-n dhe BE-në, dhe duke kontribuar në operacione dhe misione të caktuara me MPFSEE të saj. Ne ende besojmë se SEEBRIG mund të shërbejë shumë mirë si një kornizë dhe shembull i mirë i bashkimit dhe shkëmbimit të kapaciteteve të vendeve tona për emergjencat civile rajonale dhe operacionet ushtarake të NATO-s”.

Oratorët theksuan përfitimet dhe sfidat e 20 viteve të funksionimit të SEEBRIG, si dhe planet e ardhshme. Ceremonia u përmbyll me një paradë solemne të flamujve të Shteteve Anëtare, selisë së SEEBRIG dhe selisë, ku grupi mbështetës drejtohej nga një regjiment. Ish komandantët dhe shefat e stafit të Brigadës së Evropës Juglindore u nderuan. Bullgaria ishte vendi i parë pritës për selinë shumëkombëshe, e cila ishte vendosur në Plovdiv. Procesi filloi në shtator 1998 me nënshkrimin e një marrëveshje kornizë për krijimin e një Forcë paqeruajtjeje Shumëkombëshe në Evropën Juglindore.

Kjo iniciativë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e besimit midis vendeve të Ballkanit, ndërveprimin e tyre dhe integrimin në strukturat Euro-Atlantike, si dhe në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit rajonal.

Takimi i paraprind zhvillimit me sukses të Konferencës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të A-5 që do të zhvillohet gjatë këtij muaji në vendin tonë

Nga data 9 deri më 11 shtator 2019 në vendin tonë u zhvillua me sukses takimi i drejtorëve të Drejtorive të Zbulimit të vendeve të Kartës së Adriatiku A-5. Takimi i shërben forcimit të bashkëpunimit rajonal në fushën e Zbulimit dhe Sigurisë, shkëmbimit të informacionit dhe ideve rreth çështjeve dhe fenomeneve me interes të përbashkët që cenojnë situatën e sigurisë rajonale dhe më gjerë, si dhe i paraprind zhvillimit me sukses të Konferencës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të A-5 që do të zhvillohet gjatë këtij muaji në vendin tonë.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Drejtoritë e Zbulimit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, të Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përfaqësues nga Komanda Amerikane në Europë (USEUCOM). Takimi u drejtua nga drejtori i Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, kolonel Fatmir Neziraj. Në takim u diskutuan një larmi temash aktuale dhe me interes për rajonin e Ballkanit, si kërcënimet asimetrike dhe hibride, informacioni në kohën e dezinformimit, cyber security si dhe mundësitë e trajnimit të përbashkët të vendeve të A-5 në fushën e Zbulimit dhe Sigurisë. Takimi u përshëndet nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Manushaqe Shehu dhe drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA, kolonel Ilir Pujo.



Do të rritet e thellohet bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes



Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku u prit në Athinë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë, Gjeneral Christos Christodoulou dhe Ministri i Mbrojtjes, SH.T.Z. Nikolaos Panagiotopoulos

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, me ftesë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë, Gjeneral Christos Christodoulou, më datë 30 Gusht 2019, zhvilloi një vizitë zyrtare në Greqi. Fillimisht, ai u prit në takim nga homologu i tij grek, me të cilin u diskutua për mjedisin e sigurisë në vendet respektive, Ballkan e më gjerë, për bashkëpunimin dypalësh në fushën ushtarake dhe perspektivën e rritjes dhe forcimit të këtij bashkëpunimi. SHSHPFA vlerësoi kontributin dhe mbështetjen e Forcave të Armatosura Greke në procesin e integritimit të Shq-



ipërisë në strukturat Euro-Atlantike si dhe rritjen e kapaciteteve operacionale të tyre. Gjatë vizitës, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku u prit në takim edhe nga Ministri i

Mbrojtjes së Greqisë, SH.T.Z. Nikolaos Panagiotopoulos, i cili vlerësoi klimën e bashkëpunimit në fushat politike dhe ushtarake ndërmjet dy vendeve si dhe kontributin e faktorit shqiptar në ndërtimin e Greqisë. Të dy palët theksuan se, në kuadër të fqinjësisë së mirë që ekziston ndërmjet dy vendeve, nevojitet të rritet e thellohet më tej edhe bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, mori pjesë në Takimin e 182 të Komitetit Usharak në nivel Shefash Shtabi të Përgjithshëm të vendeve të NATO dhe ato partnere, në Ljubjana, Slloveni në datat 13-15 shtator 2019.

Konferenca, e cila u organizua nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të Sllovenisë, gjeneralmajor Alenka Ermenc, u kryesua nga Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach dhe u mbështetet në secilën seancë nga Komandanti Suprem për Evropën (SACEUR), gjeneral Tod D. Wolters dhe komandanti i Komandës së Transformimit (SACT), gjeneral Andre' Lanata.

Përpara Konferencës, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, u takua me Presidentin e Sllovenisë, Z. Borat Pahor, dhe zyrtarë të nivelit të lartë politik dhe ushtarak. Pas një takimi në Ministrinë e Mbrojtjes, Kryetari shfrytëzoi rastin për të lavdëruar përpjekjet e nënkolonelit Matjaž Bizjak dhe i paraqiti Medaljen e Shërbimit të Meritës të NATO-s për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në Zyrën Ndërlidhëse të



Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku
në Ljubjana, Slloveni

Takimi i 182-të i Komitetit Ushtarak të vendeve të NATO-s

Komiteti Ushtarak i NATO mbledhet dy herë në vit në Selinë e NATO, Bruksel, në nivelin e Shefave të Mbrojtjes dhe një herë në vit ata takohen në një vend anëtar të NATO-s

NATO-s në Beograd.

Gjatë Konferencës, Shefat Aleatë përqendruan vëmendjen e tyre në operacionet, misionet dhe aktivitetet e NATO-s, pengimin dhe mbrojtjen e zonës euro-atlantike, konceptin luftarak të NATO-s dhe instrumentin ushtarak të fuqisë. Në fokus të diskutimeve në konferencë ishin misionet, aktivitetet operative, si dhe ndërtimi i një koncepti lufte në një mjedis modern të sigurisë që do të jetë në gjendje të përmbushë sfidat bashkëkohore të sigurisë. Ndërsa Aleanca përballlet me sfida nga drejtime të shumta, Shefat e Mbrojtjes vunë në dukje

domosdoshmërinë e sigurimit të gatishmërisë dhe reagimit të forcave të NATO-s, dhe nevojën për të vazhduar të ketë një frenim dhe mbrojtje të besueshme dhe efektive. Shefat e Mbrojtjes dhe komandantët strategjikë në Konferencën e Komitetit Ushtarak të NATO shkëmbyen mendime mbi çështje aktuale të mbrojtjes dhe të sigurisë, të rëndësishme për Aleancën, si pjesë e përpjekjeve të saj për paqen dhe sigurinë. Gjatë diskutimeve të tyre, Shefat e Mbrojtjes theksuan përkushtimin e vazhdueshëm ndaj tre detyrave thelbësore të NATO-s-mbrojtjen

kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese.

Në konferencën e përbashkët për shtyp midis shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA të Sllovenisë, gjeneralmajor Alenka Ermenc dhe Kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, ky i fundit ka falënderuar Slloveninë për kontributet në Aleancë. Ai gjithashtu vlerësoi profesionalizmin e ushtarëve të tyre të vendosur në operacionet e NATO-s. Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, deklaroi se, "Megenëse situata e sotme e sigurisë është një nga më të paparashikueshmet në shumë vite, angazhimi i Aleancës për parandalimin e konfliktit dhe ruajtjen e paqes për gati një miliard njerëz në të dy anët e Atlantikut mbetet konstante".

"Sfidat e sigurisë me të cilat përballemi së bashku si aleatë, të gjithë 29 prej nesh, po bëhen globale. Ne kemi parë vitet e fundit që sistemi i bazuar në vlera që ne të gjithë e ndajmë, përfshirë këtu edhe në Slloveni, është nën presion. Aneksimi i paligjshëm i Krimesë, në 2014 dhe destabilizimi i vazhdueshëm i Ukrainës Lindore nga Rusia është një shembull i kësaj. Një fushë tjetër ku ne e shohim atë sfidë është lufta kundër terrorizmit. Ndërsa kujtojmë që kanë kaluar 18 vjet nga data 11 shtator i kësaj jave, NATO-ja ka luajtur një rol kryesor në luftën kundër terrorizmit që nga ajo kohë dhe është hera e parë dhe e vetme në historinë tonë që thirrret neni 5, elementi ynë i mbrojtjes reciproke", tha ai.

Komiteti Ushtarak i NATO mbledhet dy herë në vit në Selinë e NATO, Bruksel, në nivelin e Shefave të Mbrojtjes, për të diskutuar rreth operacioneve të NATO si dhe ti sigurojë Këshillit të Atlantikut të Veriut këshilla ushtarake të bazuara në konsensus, se si Aleanca mund të përmbushë më së miri sfidat globale të sigurisë, dhe një herë në vit ata takohen në një vend anëtar aleat.



Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku në Bukuresht

Konferenca e 13-të e Shefave të Shtabit të Vendeve të Ballkanit

Më 4 shtator 2019, u zhvillua në kryeqytetin e Rumanisë, Bukuresht, në hotel "Marriott", Konferenca e 13-të e Shefave të Shtabeve të Ballkanit (BCHOD).

Në aktivitetin e organizuar nga Shtabi i Mbrojtjes të Rumanisë, moren pjesë nëntë delegacionet e iniciativës si: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Turqia dhe, si vëzhgues, Kroacia dhe Sllovenia.

Ne Konferencën e 13-të e Shefave të Shtabeve të Ballkanit (BCHOD) mori pjesë Shefi

“ Morën pjesë shefat e Shtabeve të ushtrive të Shqipërisë, Turqisë, Greqisë, Rumanisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Bullgarisë, Serbisë dhe Bosnje-Hercegovinë

i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Përveç Shefave të Shtabit të vendeve të Ballkanit, në Konferencë morën pjesë Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Marshal Stuart Pitch, Përfaqësuesi i Kryetarit të Komitetit Ushtarak të

BE-së, Gjeneral Brigade Fernando Paglialunga, Zëvendës Komandanti i Forcave të Përbashkët të Napolit, Gjeneral Lejtënant Omer Lavoie dhe Zëvendës Shefi i Shtabit të Ushtrisë Sllovene Brigadierit i Përgjithshëm Robert Glavas.

Në takim u prezantua raporti vjetor i Grupit të Koordinimit si





dhe në përfundim u firmos një deklaratë e përbashkët nga shefat e shtabeve.

Iniciativa e Shefave të Shtabave të Ballkanit ka për qëllim promovimin e stabilitetit rajonal dhe prosperitetit duke forcuar bashkëpunimin ushtarak të shteteve të Ballkanit, si dhe një model për t'iu përgjigjur të gjitha sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë.

Objektivat e konferencës ishin: zhvillimi i bashkëpunimit rajonal, zhvillimi i bashkëpunimit rajonal pamje e pjesëmarrjes së përbashkët në ushtrime dhe misione të ndryshme. Ribashkimi vjetor i CHOD-ve të vendeve të Ballkanit është një iniciativë rajonale e themeluar në vitin 2007. Qëllimi kryesor i këtij forumi është ngritja e nivelit të bashkëpunimit, kërcënime të mundshme asimetrike dhe kriza jo ushtarake.

Në përfundim të konferencës, Shefi i Shtabit të Mbrojtjes të Rumanisë, gjenerali Nicolae Ciuca dhe Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Shefi i Ajrit Marshal Stuart Peach, kanë bërë deklaratë për shtyp.

Konferenca e Shefave të Shtabeve të Ballkanit (BCHOD) u krijua me iniciativën e Athinës dhe Ankarasë në vitin 2007, me qëllim forcimin e modelit



të bashkëpunimit ushtarak të shteteve të Ballkanit. Përbëhet nga përfaqësues nga Shqipëria,

Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Turqia.



Rama: Tërmeti, të kontaktohet çdo qytetar në vështërsi

Të dielën, më 22 shtator, në takim me prefektë, drejtues të Forcave të Armatosura dhe Emergjencave Civile, e ku morri pjesë edhe Kryeministri Rama dhe Ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj, Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka nënvizoi se pas masave të marra për akomodimin e qytetarëve që refuzojnë të hyjnë në banesa, po vijohet me vlerësimin e dëmeve. “Ka qenë një natë shumë intensive për të gjitha shtabet e emergjencës, bluzat e bardha, forcat e armatosura. Kemi qenë të gjithë në terren për të lehtësuar pasojat e tërmetit dhe ndihmuar njerëzit, që për shkak të panikut dhe dëmtimeve e kanë kaluar natën jashtë. Do bëjmë maksimumin për të akomoduar gjithsecilin. Janë ngritur shumë qendra që mund të presin qytetarët, kryesisht në Tiranë dhe Durrës, por mund të bëhet një punë edhe më e mirë, jo vetëm nga shtabet e emergjencës, por nga të gjithë ne, që askujt të mos i mungojë kujdesi në këto ditë të vështira. të ngremë një orë e më parë grupet e vlerësimit për të vlerësuar dëmin real të tërmetit dhe për të siguruar të gjithë qytetarët se do bëjmë maksimumin për t’i dëmshpërblyer”, tha Ministria e Mbrojtjes.

Ministri i Punëve të Brendshme Sandër Lleshaj njoftoi gatishmërinë e përforcuar të, jo vetëm të Policisë së Shtetit, por edhe të zjarrfikësve. Ai kërkoi kontaktin me çdo banor dhe të vlerësohet dhe dokumentohet çdo dëm i shkaktuar. Nga ana e tij kryeministri Edi Rama, i kushtoi rëndësi informacionit, duke i bërë apel qytetareve që janë ende të frikësuar dhe në stres që

plasaritjet jo domosdoshmërisht përbëjnë rrezik.

“Çdo plasaritje të inspektohet dhe çdo cenim i dukshëm i çdo pallati të inspektohet, pasi mund të jetë reagimi i ‘fugës sizmike’, por mund të jetë edhe cenim strukturor që e bën të rrezikshëm. Kështu që unë do të kërkoja si gjë të parë, të gjithë të spostohemi në Durrës, me një synim. Çdo familje që hyn në atë rrethin e parë të stresit dhe që dje gjatë gjithë natës ka qëndruar jashtë të kontaktohet”, nënvizoi

Kryeministri.

Sa i përket dëmeve nëpër banesa, kryeministri Rama kërkoi angazhimin e specialistëve të Institutit të Ndërtimit për inspektimin e dëmeve të shkaktuara në strukturat e ndërtesave dhe krijimin e dosjeve për gjendjen e çdo godine. Gjithashtu, kreu i qeverisë përmendi si një histori suksesi përvojën e fshatrave të Korçës dhe Ersekës, shtëpitë e të cilave po rindërtohen dhe do të jenë gati përpara nisjes së reshjeve.



Më pas mbledhja vijoi nën drejtimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i cili bashkë me drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile Haki Çako shpërndanë detyrat për të zbatuar urdhrat dhe porositë e lëna nga kryeministri Rama.

Sipas informacioneve zyrtare deri ditën e martë, më 24 shtator, 132 persona u paraqiten për të marrë ndihmën mjekësore në spitalin e Durrësit dhe të Tiranës, kryesisht me dëmtime të shkaktuara nga rrëzimet apo goditjet. Për fat të mirë tërmeti më i fuqishëm i 3 dekadave të fundit nuk shkaktoi asnjë viktimë. Lëkundjet e forta shënuan dëme shumta në banesa dhe biznese. Dëmet më të mëdha janë shënuar në banesa, kryesisht në Durrës dhe Tiranë. Deri tani numërohen 569 banesa të dëmtuara si dhe 53 pallate. Nuk mungojnë dëmet në edhe në 5 shkolla, një qendër shëndetësore, 4 automjete, një kabinë elektrike dhe 1 urë të varur. Shtabet e emergjencave, në koordinim me të gjitha bashkitë e vendit kanë dalë në terren për të evidentuar të gjitha dëmet e shkaktuara nga tërmeti.



NË TEREN 500 EFEKTIVË TË FA

Ministrja Xhaçka: Verifikim për çdo banesë të dëmtuar

500 efektivë të Forcave të Armatosura janë atashuar në terren në gjendje gatishmërie

“**K**a një mobilizim të të gjitha resurseve dhe energjive të shtetit shqiptar si kurrë më parë. Pasi edhe pse situata duket e tejkaluar, edhe pse dëmtimet fatmirësisht rezultojnë modeste, kemi zgjedhur të kalojmë në një gjendje gatishmërie maksimale duke e kuptuar fare mirë që kjo është ajo që presin dhe që meritojnë qytetarët në këto orë të vështira për të gjithë.

Kështu, janë shpërndarë në terren dhjetëra ekipe të shtabeve



të emergjencave pranë prefekturave e bashkive, 1400 efektivë të Policisë së Shtetit, disa qindra efektivë të Policive Bashkiake të Durrësit e Tiranës, 500 efektivë të Forcave të Armatosura të atashuar pranë ekipeve të terrenit apo në gjendje gatishmërie sipas nevojës”, deklaroi ministrja e Mbrojtjes, zonja Olta Xhaçka, para medias, ditën e dielë, me 22 shtator 2019.

“Niveli i bashkëpunimit dhe reagimit mes institucioneve, tha ministrja Xhaçka, ka qenë shumë efikas, duke filluar nga prefekturat e njësitë e qeverisjes lokale, e duke vazhduar me policinë, shëndetësinë, infrastrukturën, zjarrfikëset, arsimin dhe Forcat e Armatosura. 24 orët e para pas tërmetit ishin sigurisht orë emergjence kur presioni mbi çdo drejtues e çdo efektiv, mjek apo punonjës të përfshirë në këtë sipërmarrje ka qenë i jashtëzakonshëm. Dua t’i falënderoj të gjithë për punën e bërë dhe besoj që sot çdo qytetar duhet t’u jetë mirënjohës këtyre burrave e grave, djemve e vajzave, të cilët sigurisht kanë përjetuar të njëjtën frikë e ankth si çdo qytetar i Tiranës e Durrësit, por janë ngritur në lartësinë e detyrës”.

BE: Angazhim për pasojat e tërmetit, ndihma dhe asistencë

Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian mbështet dhe ndihmon Shqipërinë në menaxhimin e situatës pas tërmetit të 21 shtatorit, që preku disa qarqe të vendit.

Një ekip i specializuar i këtij Mekanizmi ka mbërritur në Tiranë, duke iu atashuar ekipeve shqiptare të emergjencës për vlerësimin e dëmeve në terren dhe ofrimin e asistencës së tyre.

Më 28 shtator 2019, në një deklaratë të përbashkët për shtyp me ambasadorin e Delegacionit të BE në vendin tonë, Luigi Soreca dhe drejtuesin e ekipit të BE për Emergjencat Civile, Peter Glerum, ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka vlerësoi aktivizimin e menjëhershëm të asistencës së BE pas tërmetit, që shkaktoi jo pak shqetësim tek qytetarët.

“E vlerësoj akoma më shumë këtë mbështetje, për faktin që Shqipëria sot nuk është e anëtarësuar në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Europiane. E megjithatë jemi dëshmitarë të një shfaqje kaq të bukur dhe domethënëse solidariteti. Dua të falënderoj çdo vend që përmes këtij Mekanizmi, bujarisht ka vendosur që të na mbështesë në këto momente të vështira.

Ka kaluar shumë pak kohë, që kur Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri për Mbrojtjen Civile dhe, tërmeti i datës 21 shtator, ishte testi i parë i këtij mekanizmi që është ende në hapat e para dhe që kërkon ende shumë punë, koordinim, transformim institucional e përgjegjësisht, përpara se të bëhet vërtet funksional. Por ishte një test që gjithsesi tregoi se çfarë potenciali të jashtëzakonshëm ka ky mekanizëm, i ndërtuar mbi modelet që funksionojnë sot në BE”, - tha ministria në deklaratën e saj.



Kanë nisur të mbërrijnë në Shqipëri ndihmat e para nga Greqia, Hungaria, Austria, Italia, Sllovakia, Sllovenia, Norvegjia, Franca, Gjermania dhe Britania e Madhe.



Ambasadori Soreca, pasi përgëzoi autoritetet shqiptare për menaxhimin e situatës, konfirmoi se Bashkimi Europian do të jetë gjithmonë në krah të Shqipërisë. “Shqipëria është afër nesh edhe në zemrat tona, në shqetësimet tona. Përgëzoj reagimin e shpejtë të vendeve të BE, që i qëndruan

pranë Shqipërisë. Vetëm pak ditë pas aktivizimit të këtij mekanizmi kemi një ekip me 8 ekspertë, që është i formuar nga Qendra e Reagimit të Emergjencave. Ekipi do të mbikqyrë dhënien e të gjitha sendeve. Janë autoritet shqiptare që po udhëheqin punën. Tërmetet kanë treguar nevojshmërinë për një Agjenci të fortë të Mbrojtjes Civile”, - tha ai.

Siç bëri me dije edhe shefi i ekipit nga ERCC Peter Glerum, ekspertët e këtij mekanizmi gjatë 2 javëve të qëndrimit në Shqipëri do të vizitojnë në terren dëmet e shkaktuara për të bërë vlerësimin e situatës në mbështetje të autoriteteve respektive të qeverisë shqiptare.

Ndërkohë, prej ditës së djeshme kanë nisur të mbërrijnë në Shqipëri ndihmat e para nga Hungaria, Greqia, Austria, Italia, Sllovakia, Sllovenia, Norvegjia, Franca, Gjermania dhe Britania e Madhe.

Nikolaos Hardalias: Solidaritet dhe mbështetje për popullin shqiptar



Mbërrinjë në Shqipëri ndihmat e parë të Bashkimit Evropian për familjet e prekura nga tërmeti i 21 shtatorit. Pas aktivizimit të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE, në Drejtorinë Rajonale të Rezervave të Shtetit në Lundër, kanë mbërritur ndihma nga disa shtete evropiane si Greqia, Kroacia, Hungaria, ndërsa priten edhe nga shtete të tjera. Një avion ushtarak grek solli ditën e dielë kontributin e qeverisë së Greqisë për Shqipërinë. Në ceremoninë e pritjes ishte i pranishëm edhe drejtuesi i ekipit të BE për Emergjencat Civile, Peter Glerum. "Ne jemi këtu si skuadër e Mbrojtjes Civile për të ndihmuar Shqipërinë. Ne kemi marrë deri më tani ndihmat e dhëna nga 3 shtete dhe presim edhe nga shtetet e tjera", u shpreh përfaqësuesi i BE. Nga ana e tij, sekretari i Përgjithshëm i Mbrojtjes Civile të Greqisë, Nikolaos Hardalias tha se jemi këtu të japim një mesazh solidariteti dhe mbështetje për popullin shqiptar.

Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave të Shtetit, Paulin Luli falënderoi

në emër të Ministrisë së Mbrojtjes përfaqësuesit e lartë të Mbrojtjes Civile për solidaritetin. "Shpresojmë që ne këtë ndihmë të dhënë të mos e kthejmë vetëm në raste të tilla, por të jemi krah njëri-tjetrit për të ndihmuar në kohë të vështira", u shpreh drejtori i Rezervave të Shtetit. Një ekip i specializuar i Mekanizmit të

Mbrojtjes Civile të BE ka mbërritur në Tiranë, duke iu atashuar ekipeve shqiptare të emergjencës për vlerësimin e dëmeve në terren dhe ofrimin e asistencës së tyre. Prezantimi u edhe nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka në prani edhe të ambasadorit të Delegacionit të BE në vendin tonë, Luigi Soreca.

Kreu i Emergjencave Civile, Haki Çako, dëmet nga tërmeti

1528 objekte të dëmtuara, 50 banesa plotësisht dhe plasaritur 160 pallate

Kreu i Emergjencave Civile, Haki Çako, ka publikuar ditën e martë, 23 shtator, shifrat e para të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i fuqishëm i pasdites së të shtunës me magnitudë 5.8. Sipas tij, janë 1528 objekte të dëmtuara, nga të cilat 50 banesa janë shkatërruar plotësisht. "Nga raporti i fundit operativ, rezulton që janë raportuar 1528 objekte të dëmtuara, nga të cilat janë shkatërruar plotësisht 50 banesa, kryesisht në zonat rurale, janë plasaritur rreth 160 pallate, një qendër shëndetësore, 34 shkolla, 13 universitete publike, 2 kabina elektrike, 1 magazinë, 2 ura, 4 automjete. Të gjitha këto janë duke u monitoruar dhe vlerësuar situatën drejtpërdrejt. Mjetet u dëmtuan nga rënia e suvave dhe materialeve të ndryshme. Nuk duket të ketë dëme në strukturë të godinave në përgjithësi, por edhe të Gjeologji-Minierave, nga të dhënat e deri tanishme. Janë një sërë fshatrash të Durrësit, por edhe të Tiranës, Ndroqit, Vorës, Maminasit, ku bane-



sat janë shkatërruar. Banorët janë sistemuar, është çuar një numër i konsiderueshëm çadrasash për ata që nuk kanë dashur të largohen nga banesat e tyre", tha Çako.

Ndërkohë, sipas kreut të Emergjencave Civile, Haki Çako gru-

pet e inspektimit të ngritura për konstatimin e dëmeve, vijojnë punën për vlerësimin e tyre. "Situata është normale, të gjitha strukturat e njësive vendore janë në mbështetje të nevojave të qytetarëve si dhe në kontakt për konstatimin e më pas vlerësimin e dëmeve të shkaktuara", theksoi Çako. Ai bëri të ditur se "në shkallë vendi janë ngritur 62 grupe konstatimi të cilat vazhdojnë verifikimin në terren dhe evidentimin e dëmeve të konstatuara. Qendra pritje të hapura janë gjithsej 9, nga të cilat 6, në Tiranë dhe 3 në Durrës. Gjithashtu në dispozicion të qytetarëve janë zyrat e njësive administrative të bashkive të qarqeve". Kreu i Emergjencave Civile tha se vëmendja është maksimale për t'iu gjendur pranë familjeve të prekura.

Arsimimi Ushtarak i Forcave të Armatosura Akademia e FA do akreditohet si institucion i arsimit të lartë

Për vitin 2019-2020 do të ulen në auditore 182 ushtarakë nga Shqipëria, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia, Greqia, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Gjeorgjia dhe Kosova.

Këshilli i Ministrave pritet të miratojë së shpejti statusin e veçantë për Akademinë e Forcave të Armatosura, duke hapur kështu rrugën ndryshimit rrënjësor të sistemit arsimor ushtarak në vendin tonë. Ky status, mundëson jo vetëm hapjen e studimeve të ciklit të parë bachelor por edhe akredimin e plotë të AFA dhe programeve akademike.

Sipas njoftimit të zyrës së shtypit të Ministrisë së Mbrojtjes, të ditës së premte, datë 20 shtator 2019, këtë lajm, ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e ndau me studentë e pedagogë të Akademisë së Forcave të Armatosura në nisje të vitit të ri akademik 2019-2020, ku e ftuar ishte edhe ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Besa Shahini. "Falë këtij transformimi, që në vitet që do të vijjnë do të duhet ta çojmë edhe më tej, në Forcat e Armatosura po instalohet sot një sistem i mirëfilltë meritokracie dhe një nivel profesionalizmi që deri pak vite më parë ishte i paimagjinueshëm. Efektivët tanë tonë janë sot në gjendje të marrin pjesë në misione kudo ku shfaqet

nevoja, për të kontribuar për sigurinë tonë kolektive, duke u angazhuar si të barabartë, krahas për krahas kolegëve të tyre në disa prej ushtrive më moderne e profesioniste. Kjo akademi ka sot një rol vërtet shumë të rëndësishëm strategjik për transformimin e ushtrisë shqiptare. Forca e Armatosur që po ndërtojmë sot është në fakt shumë e ndryshme nga ajo që trashëguam. Aty ku dikur kishim një forcë të bazuar tek rekrutimi i detyruar, sot kemi një forcë më të vogël, profesioniste e vullnetare. E mbi të gjitha kemi një forcë që duhet të arrijë standardet e NATO që janë padyshim standardet më të larta që duhet të respektojnë një forcë ushtarake kudo në botë", tha ministria e Mbrojtjes në fjalën e saj.

Për ministren Shahini, vendimi i ardhshëm i Këshillit të Ministrave hap një faqe të re për arsimimin e ushtarakëve shqiptarë.

"Ky nuk është një institucion i zakonshëm i arsimit të lartë, ndaj ne jemi duke punuar fort bashkë me Ministrinë e Mbrojtjes që t'i japim një status të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, që stafi akademik të trajtohet



i njëjtë si institucionet e tjera të arsimit të lartë”, - nënvizoi ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Në ceremoninë e organizuar mori pjesë edhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, Gjeneralbrigade Bardhyl Kollcaku, Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, Generalbrigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, Zv. Komandanti/ Zv. Rektori i AFA Kolonel Edmond Braneshi, Komandantët e Forcave, njësave, reparteve dhe strukturave të FA, drejtorë drejtorish në MM e SHPFA, kursantë të kurseve institucionale dhe pedagogë të AFA.

“Për të 11-in vit radhazi, kemi në auditoret tona kursantë nga vendet anëtare dhe partnere në NATO, të cilët do të ndjekin studimet e avancuara në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, një ndjenjë kjo edhe krenarie që Shqipëria arrin të sigurojë studime të kësaj natyre. Me këtë rast, një falënderim i veçantë shkon për të gjitha vendet mike dhe aleate të Gjeorgjisë, Greqisë, Italisë, Kroacisë, Anglisë, Maqedonisë së Veriut, Turqisë, autoriteteve të larta të këtyre vendeve për vlerësimin e këtij kursi, duke dërguar oficerë madhorë e me detyra të rëndësishme në vendet e tyre respektive, dhe jo vetëm. Edhe pranimi e mirëpritja e ftesës sonë për të dërguar lektorët e tyre si “guest speaker” në këtë kurs. Unë i siguroj ushtarakëve të huaj se te ne do të gjejnë hapsirën e duhur për të marrë jo vetëm informacion bashkëkohor, por edhe për të shprehur lirshëm dhe diskutuar opinionet dhe eksperiencën e vendeve të tyre në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Në të njëjtën kohë ata do të gjejnë traditën mikëpritëse shqiptare dhe do të njihen me historinë, kulturën dhe traditat e vendit tone”, tha Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, Generalbrigade Prof. Asoc. Bajram Begaj.

Për të njëmbëdhjetin vit radhazi, Akademia e Forcave të Armatosura ka hapur dyer për studentë nga disa vende të rajonit. Për vitin 2019-2020 do të ulen në auditore 182 ushtarakë nga Shqipëria, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia, Greqia, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Gjeorgjia dhe Kosova.

PËRFUNDON STËRVIÇJA “ALBANIAN EFFORT 19”

Khacka: Stërviçje të tilla ndërtojnë fuqinë e Aleancës

Stërviçja “Albanian Effort 19” shërbeu gjithashtu për certifikimin e Kompanisë II “Komando” e deklaruar nga vendi ynë në NATO si pjesë e Task-Forcës së Gatishmërisë Shumë të Lartë

“**A**lbanian Effort 19” mbledhi në Bizë rreth 800 efektivë nga Shqipëria, SHBA, Mbretëri e Bashkuar, Turqia, Kroacia, Polonia, Italia, Gjermania, Bullgaria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova. Në shtatë ditë përfaqësuesit ushtarakë nga 12 vende aleate dhe partnere treguan se cili është burimi i fuqisë së Aleancës më të madhe ushtarako-politike në botë, anëtare e së cilës vendi ynë është prej 10 vjetësh. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaka në një video-mesazh drejtuar efektivëve vuri në dukje me



krenari se kjo është stërviçja e parë ku planifikimi dhe mbështetja logjistike u krye tërësisht nga Forcat e Armatosura shqiptare. “Shqipëria u anëtarësua në NATO vetëm 10 vjet më parë. Fakti që vetëm një dekadë më pas, Forcat tona të Armatosura janë shndërruar në një forcë moderne e profesionale, e cila është në gjendje të operojë në standardet e NATO, është një dëshmi e asaj që e bën Aleancën unike. Mbështetja dhe solidariteti mes aleatëve është ajo që e bën NATO një forcë kaq të fuqishme”, - theksoi ministria e Mbrojtjes në mesazhin e saj.

Për shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollcaku, trupat shqiptare po stërviçen së bashku me ato të Aleancës dhe vendeve partnere për planëzimin dhe kryerjen e operacioneve në përgjigje të krizave dhe për një sërë elementesh të rëndësishëm. Stërviçja “Albanian Effort 19” shërbeu gjithashtu për certifikimin e Kompanisë II “Komando” e deklaruar nga vendi ynë në NATO si pjesë e Task-Forcës së Gatishmërisë Shumë të Lartë (Very High Readiness Joint Task Force, VJTF).

Gjeneral Kollçaku: Stërvitja ishte në përputhje Direktivën e NATO-s

Në rajonin stërvitor të Bizës u zhvillua më 18 shtator, “Dita e Vizitorëve të Shqar” të stërvitjes shumëkombëshe me trupa, e koduar “Albanian Effort-19”. Në këtë ceremoni morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Mullai, gjeneralë të ftuar nga vendet pjesëmarrëse në stërvitje, komandantë forcash, atashe ushtarakë të vendeve të NATO të akredituar në vendin tonë, etj.

Në fjalën përshëndetëse komandanti i FT, gjeneral brigade Mullai theksoi rëndësinë e kësaj stërvitje për përmirësimin e ndërveprueshmërisë mes forcave aleate e partnere, për rritjen e rentabilitetit të punës së shtabeve në procesin e vendimmarrjes si dhe familjarizimit me gjuhën e standardet e NATO Ai falënderoi specifikisht për punën e shkëlqyer Batalionin Komando efektivat e të cilëve u certifikuan. Njëkohësisht gjeneral brigade Mullai falënderoi të gjithë vendet pjesëmarrëse aleate e partnere, të cilët treguan edhe njëherë se forca e vërtetë e NATO qëndron te kohezioni, te ndërveprimi dhe te gatishmëria për reagim të përbashkët ndaj rreziqeve të çdo lloji në hapësirën euroatlantike e më gjerë. Ai falënderoi Batalionin Komando, por edhe gjithë trupat e vendeve aleate e partnere pjesëmarrëse në stërvitje për angazhimin e djersën e derdhur sëbashku, si dhe garantoi mbështetjen e pandërprere të SHPPFA në procesin e forcimit e modernizimit të FA në tërësi.

Në përshëndetjen e drejtuar trupave pjesëmarrëse në këtë stërvitje, gjeneral brigade Kollçaku u shpreh ndër të tjera: “Ne jemi këtu, në këtë



“Ditë të Vizitorëve të Shqar”, të Stërvitjes “Albanian Effort-19”, ku marrin pjesë 12 vende të NATO dhe vende partnere. Ne e planifikuam atë si një ushtrim kombëtar-vendas dhe tani jemi këtu, kemi një batalion shumëkombësh. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte të përmirësonte njohuritë, të kuptuarit dhe aftësinë e strukturave të Forcave të Armatosura, udhëheqësve dhe partnerëve ndërkombëtarë, në planifikimin dhe ekzekutimin e spektrit të plotë NA5CRO, si pjesë e një Task Force të përbashkët (CJTF) të NATO me fokus në nivelin taktik. Padyshim që qëllimi u arrit me sukses dhe të gjitha objektivat u përmbushën.”-u shpreh gjeneral brigade Kollçaku.

Më tej gjatë fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku u ndal në rëndësinë që kanë këto stërvitje të përbashkëta shumëkombëshe me trupa, kur aleatët dhe partnerët e NATO bëhen së bashku për të punuar, trajnuar, bashkëpunuar dhe demonstruar ndërveprueshmërinë që ata kanë. “Unë jam i privilegjuar dhe dua të shfrytëzoj

rastin për të falënderuar të gjithë aleatët tanë dhe pjesëmarrësit e vendeve partnere këtu, për punën e shkëlqyer dhe kontributin që ata kanë dhënë në këtë stërvitje. Unë e vlerësoj shumë! Me njerëz të tillë, miq dhe profesionistë, sukcesi i stërvitjeve tona ushtarakë dhe angazhimeve të përbashkëta mbeten të garantuara! Por, duke parë përtej suksesit profesional të stërvitja “Albanian Effort-19”, unë mendoj se stërvitje si kjo dërgojnë një mesazh shumë të fortë, se nuk është vetëm Shqipëria, që është e interesuar për siguri dhe mbrojtje këtu në rajonin e Ballkanit, por janë të gjithë fqinjët tanë, vendet e rajonit dhe aleatët e NATO, që punojnë së bashku. Ne duhet ta kemi parasysh këtë dhe të vazhdojmë të punojmë si një ekip.” - u shpreh gjeneral brigade Kollçaku. Ceremonia e Ditës së Vizitorëve të Shqar të stërvitjes “Albanian Effort - 19” përfundoi me dhënie e medaljeve, certifikatave, si dhe me një deklaratë për shtyp të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH.

Ditën e shtunë, më 7 shtator, në mjediset e Shtabit të Përgjithshëm u organizua ceremonia e dorëzimit të gradave për ushtarakët e Shtabit të Përgjithshëm dhe njërive vartëse të tij.

Në ceremoni ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Manushaqe Shehu, drejtorë të Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantë. Në fjalën e tij përshëndetëse gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku theksoi se, sot me këtë ceremoni po realizojmë dorëzimin zyrtarisht të gradave për personelin e Shtabit të Përgjithshëm dhe njërive të vartësisë. Ai vlerësoi dhe falënderoi Komisionin e Lartë të Karrierës dhe Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave për punën dhe përmbylljen me sukses të këtij procesi të rëndësishëm për Forcat e Armatosura siç është promovimi në gradë dhe kualifikimi për ushtarakët të cilëve i lind e drejta për aplikim e konkurrim.

Më pas, përfaqësuesi i Drejtorisë së Personelit të Shtabit të Përgjithshëm lexoi Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes për dhënien e gradave personelit oficer dhe nënoficer të personelit ushtarak të Shtabit të Përgjithshëm e njërive të vartësisë, proces, i cili u pasua me dorëzimin e gradave të radhës. Kolonel Hamdi Doda përshëndeti në emër të kolegëve të tij që morën gradën e kolonelit duke përshkruar emocionet pozitive të kësaj dite ndërkaq edhe falënderoi për besimin dhe premtori se do të përmbushë me sukses çdo detyrë që do t'i ngarkohet. Ndërsa Morena Halilaj, e cila sapo kishte vënë në supe gradën e kapitenes, përshëndeti në emër të vajzave të sapo graduara. Gjithashtu edhe kapitene Halilaj falënderoi për këtë promovim si dhe siguroi drejtuesit se do të vazhdonte të punonte me korrektësi, seriozitet dhe profesionalizëm.

Në Forcat e Armatosura personeli oficer që ju ka lindur e drejta për gradën e radhës kanë qenë 412, nga të cilët, bazuar në kuotat e përcaktuara, janë graduar 210, ndërsa personeli nënoficer që ju ka lindur e drejta për gradën e radhës kanë qenë

Gradime në Shtabin e Përgjithshëm dhe strukturat vartëse

Në Forcat e Armatosura personeli oficer që ju lindi e drejta për gradën e radhës kanë qenë 412, nga të cilët, bazuar në kuotat e përcaktuara, janë graduar 210, ndërsa personeli nënoficer që ju ka lindur e drejta për gradën e radhës kanë qenë 443, nga të cilët, bazuar në kuotat e përcaktuara, janë graduar 373.



443, nga të cilët, bazuar në kuotat e përcaktuara, janë graduar 373. Ceremonia u përmbyll me realizimin

e një fotoje të përbashkët të sapo të graduave dhe të pranishmëve në ceremony.

Korrik-gusht, 324 varta zjarri në shkallë vendi

Muajt korrik edhe gusht edhe pse më të nxehtët e vitit shënuan një numër të pazakontë zjarresh. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka thekson se gjatë kësaj periudhe në vend ka pasur 324 varta zjarri. Ministria, duke paraqitur të dhëna konkrete bën me dije se, pjesa më e madhe e tyre kanë qenë zjarre të qëllimshme; arsye kjo për të cilën, të gjithë ata që kanë shkatërruar pronën publike dhe kanë rrezikuar jetën e qytetarëve do të përgjigjen përpara ligjit.

"Pavarësisht punës së jashtëzakonshme të Emergjencave Civile, Forcave të Armatosura, zjarfikësve dhe ndihmës së qytetarëve të shumtë, që na u bashkuan si vullnetarë, korriku dhe gushti shënuan një numër të pazakontë zjarresh. 324 varta zjarri në mbarë territorin e vendit, 1.900 ha pyje, toka bujqësore, kullota, nga zjarre që në 99% të rasteve kanë ardhur jo nga temperaturat e larta, por nga zjarrvënia e qëllimshme! Ligji do të veprojë me ashpërsinë më të madhe ndaj autorëve të këtyre akteve që rrezikojnë të mirën tonë të përbashkët." - shprehet ministria Xhaçka. Ministria e Mbrojtjes thekson se, Emergjencat Civile vijojnë të jenë në krye të detyrës për të mbrojtur pronën publike e private, e mbi të gjitha jetën e qytetarëve.



Gjeneral Begaj në diplomimin e 7 kadetëve shqiptarë në Turqi

U diplomuan 7 studentë shqiptarë, prej të cilëve 3 oficerë nga Akademia e Forcave Tokësore, 2 oficerë nga Forca Ajrore dhe 2 oficerë nga Akademia e Forcës Detare.

Shtatë kadetë shqiptarë përfunduan studimet në akademitë ushtarake në Turqi, mes 325 ushtarakëve të rinj nga 17 vende të botës. Në Akademinë e Forcave Detare, në Stamboll/Turqi, është zhvilluar ceremonia e diplomimit të oficerëve të rinj, midis të cilëve ishin dhe 7 studentët shqiptarë, prej të cilëve 3 oficerë nga Akademia e Forcave Tokësore, 2 oficerë nga Forca Ajrore dhe 2 oficerë nga Akademia e Forcës Detare. Në ceremoninë ku morën pjesë Presidenti i Republikës Turke, Ministri i Mbrojtjes turk, gjeneralë e ushtarakë të gradave më të larta, personalitete nga fusha të ndryshme, ambasadorë dhe atashë ushtarakë nga vende të ndryshme të botës, mori pjesë dhe Komandanti i Komandës së Doktrinės dhe Stërvtjes, Gjeneralbrigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, si dhe N/kol Majlinda Sallaku, zv/atashe ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Turqi.

Ergys Dollomaja i Forcës Tokësore, Dario Bufazi i Forcës Detare, Krist Hasanbega i Forcës Ajrore, ishin oficerët me performancën dhe rezultatet më të mira ndër studentët e tjerë, të cilëve iu akorduan diplomat nga Zv. Ministri i Mbrojtjes së Republikës Turke.

Oficeret e rinj shqiptarë e përfunduan me sukses programin e tra-



jimeve ushtarake si dhe programin bachelor. Përgjatë studimeve të tyre, ata treguan se të jesh i suksesshem si kadet ushtarak, duhet të jesh dhe ambasador i Shqipërisë në

lartësimin e vlerave të kombit shqiptar. Kadetët e sapodiplomuar shqiptarë do të kthehen të shërbejnë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë me gradën e nëntogerit.

Komandanti i Komandës së Doktrinės dhe Stërvtjes Gjeneralbrigade Prof. Asoc. Bajram Begaj priti atashëun në largim N/Kol Dirk Weber dhe i uroi suksese në detyra të tjera, gjithashtu uroi atashëun e ri N/Kol Hans-Peter Wamsler për detyrën dhe vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet forcave të armatosura.

Më pas komandanti i Komandës së Doktrinės dhe Stërvtjes Gjeneralbrigade Prof. Asoc. Bajram Begaj priti në një takim kortezie atashëun e Republikës së Turqisë kolonel Şakir Cumhur Somer. Pasi ju uroi mirëseardhjen dhe shprehu mirënjohje dhe falenderime, Gjeneralbrigade Prof. Asoc. Bajram Begaj vlerësoi bashkëpunimin dhe u shpreh i gatshëm për çdo iniciativë në fushën e arsimit dhe trajnimit për Komandën e Doktrines dhe Stërvtjes.

Gjeneralbrigade Begaj priti atashetë e gjermanisë dhe turqisë



Në kuadër të bashkëpunimit me ODC për vitin 2019 dhe vijimin e asistencës ndaj Forcës Ajrore shqiptare, në periudhën 4-13 shtator 2019, në Bazën Ajrore Farkë, u zhvillua trajnimi "Aviation Safety Management Multinational Course" nga një ekip i Akademisë së Ndërvropiane të Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Evropë. Qëllimi i këtij trajnimi ishte të krijohet një bërthamë me specialistë të sigurisë së fluturimeve për Forcën Ajrore dhe Aleancën, që zotërojnë njohje dhe kuptim të përbashkët të parimeve, procedurave dhe sfidave të sigurisë së aviacionit, si dhe të mundësojë operacione të përbashkëta ajrore në Evropë duke përmirësuar sigurinë e operacioneve ajrore me Forcat Ajrore amerikane, aleatët e NATO dhe partneritetit për paqe. Në këtë trajnim morën pjesë 23 studentë nga 4 vende: Bullgaria, Estonia, Sllovakia, si dhe pilotë dhe teknikë të Forcës Ajrore shqiptare. Në përfundim të trajnimit u zhvillua një ceremoni ku mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Editsion Zarka. Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore falënderoi pjesëmarrësit për përkushtimin dhe angazhimin e përbashkët dhe vlerësoi ndërveprimin midis vendeve

Në Bazën Ajrore Farkë trajnim ndërkombëtar për pilotët

Në këtë trajnim morën pjesë 23 studentë nga 4 vende: Bullgaria, Estonia, Sllovakia, si dhe pilotë dhe teknikë të Forcës Ajrore shqiptare.



pjesëmarrëse në këtë trajnim. Kolonel Zarka shprehu bindjen se të tilla trajnime do të vazhdojnë dhe në

të ardhmen. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikata për studentët pjesëmarrës.

Në Bazën Ajrore Farkë

Në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua aktiviteti "Medical Course" (kursi mjekësor) nga një ekip i Forcës Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Evropë. Në kursin 4 ditor të zhvilluar nga ekipi i Forcës Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Evropë, merrnin pjesë pilotë dhe teknikë të Bazës Ajrore Farkë, personeli mjekësor i kësaj baze, si dhe përfaqësues nga Qendra Ndërkombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKMU). Qëllimi i aktivitetit "Medical Course" ishte të ofrohet mbështetje dhe eksperiencë në fushën e trajnimeve të personelit mjekësor të Forcës Ajrore. Ky kurs fokusohet në trajnimin e individëve, për transportin e të dëmtuarve, stabilizimin dhe transferimin e pa-

Amerikanët zhvillojnë kursin mjekësor "Medical Course"



cientëve, dhënien e ndihmës së parë, trajtimi mjekësor në fushëbetë, arrijtjen e standardeve të ndërveprimit të NATO-USA gjatë dislokimit. Temat e zhvilluara në teori dhe praktikë shërbyen për shkëmbimin e eksperiencave, implementimin e programit të Forcës Ajrore të SHBA për integrimin e përmirësimeve mbi bazat e trajnimit të individëve, transportin e të dëmtuarve, stabilizimin dhe transferimin e pacientëve, dhënien e ndihmës së parë, trajtimi mjekësor në fushëbetë.

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Forcave të Armatosura të RSH dhe Forcave të Armatosura të SHBA, në Forcën Ajrore u zhvillua aktiviteti ALBSPP 19014121CE "Senior NCO Development".

Në aktivitet merrnin pjesë tre ushtarakë nga Ushtria e SHBA dhe nënoficerët më të lartë të komandave të FT, FD, FAj, KDS, KM, Policia Ushtarake, ASNI, QPR, Batalioni i SHPFA. Qëllimi i aktivitetit ishte diskutimi mbi metodat amerikane për zhvillimin e punës në grupe me nënoficerët, si dhe filozofia e edukimit të nënoficerëve në shkollë, udhëzuesin e ushtarit dhe zhvillimin e karrierës. Ekipi amerikan u prit nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Editson Zarka.

Kolonel Editson Zarka pasi u uroi mirëseardhjen në Forcën Ajrore, shprehu mbështetjen e tij për rolin e nënoficerit në zinxhirin komandues, ku prioritet do të mbetet trajnimi dhe edukimin i trupës së nënoficerit. Aktiviteti vijoi në Bazën Ajrore Farkë, me takimin me nënoficerët e kësaj baze, ku për të pranishmit u

Me amerikanët zhvillohet aktiviteti "Senior NCO Development"

Morën pjesë tre ushtarakë nga Ushtria e SHBA dhe nënoficerët më të lartë të komandave të FT, FD, FAj, KDS, KM, Policia Ushtarake, ASNI, QPR, Batalioni i SHPFA.



bë një prezantim i përgjithshëm mbi misionin, detyrat, (detyrat e specialitetit të nënoficerit të FAj) dhe roli i nënoficerit në pozicione të ndryshme

në Forcën Ajrore. Në përfundim u zhvillua një vizitë në mjediset e Bazës Ajrore Farkë. Vizita u mbyll me një foto të përbashkët.

Forca Ajrore

Në ambientet e Komandës së Forcës Ajrore u zhvillua një ceremoni e veçantë për personelin oficer dhe nënoficer, me rastin e gradimit të tyre. Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Editson Zarka pasi i uroi punë të mbarë dhe suksese personelit të sapo graduar, u shpreh ndër të tjera se: "Grada që mbani sot do të shërbejë si një sfidë për të ardhmen, duke dhënë kontributit tuaj për realizimin e misionit të Forcës Ajrore. Jeni ju ata që me punën dhe përkushtimin tuaj do të keni fatin të përzgjidheni për të shërbyer në baza të rëndësishme si baza e ajrore e NATO që do të ndërtohet në Kuçovë, e cila do jetë një bazë e rëndësishme operacionale për NATO." Me pas nga shefi i personelit të Forcës Ajrore u lexua urdhri i ministrit të Mbrojtjes

Zhvillohet ceremonia e gradimit për oficer dhe nënoficer



dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për dhënien e gradave personelit oficerë

dhe nënoficerë. Ceremonia përfundoi me vendosjen në mënyrë simbolike të gradave të reja.

Shërbimi Hidrografik Shqiptar dhe Italian

Rilevime të përbashkëta në rajonin e Gjirit të Sarandës

Instituti i Hidrografisë italiane mori pjesë me anijen hidrografike “Aretuza”, e cila u akostua në portin e Sarandës.

Nga data 15 deri më datën 22 shtator 2019 në Gjirin e Sarandës, u zhvilluan matje të përbashkëta batimetrike dhe topografike midis Shërbimit Hidrografik Shqiptar dhe atij italian.

Në këtë aktivitet Instituti i Hidrografisë italiane mori pjesë me anijen hidrografike Aretuza, e cila u akostua në portin e Sarandës. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rilevimet e përbashkëta në rajonin Gjiri i Sarandës si dhe trajnimin e personelit të sektorit të hidrografisë në bordin e anijes Aretuza. Për të ndjekur trajnimin u imbarkuan 4 specialistë, të cilët ndoqën nga afër punën e bërë në bordin e anijes si dhe morën leksione mbi mënyrën e përdorur gjatë rilevimeve batimetrike në det, procesimi i të dhënave të marra si dhe matjet topografike të zhvilluara në tokë. Komandanti i anijes Aretuza, organizoi një pritje në bordin e saj, ku morën pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut të parë

Artur Meçollari, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, komandanti i Shërbimit Hidrografik kapiten i rangut të tretë Alfred Velaj, kryetari i Bashkisë së Sarandës z. Ardian Gurma, ambasadori italian z. Alberto Cutillo, atasheu ushtarak italian në vendin tonë kolonel Fabio Cornaçhia si dhe të ftuar të tjerë. Midis të ftuarve u theksua rëndësia që ka përditësimi i të dhënave batimetrike dhe nxjerrjen e hartave detare të përditësuara për rajonin e Sarandës ku fluksi i mjeteve detare është shumëfishuar ndjeshëm në vitet e fundit. Zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut të parë Meçollari dhe atasheu ushtarak italian kolonel Cornaçhia vunë theksin për vijimin në të ardhmen e këtyre aktiviteteve të përbashkëta, të cilat kombinohen me pune reale dhe njëkohësisht shkëmbime eksperiencash dhe të dhënash midis dy hidrografive. Në fund të aktivitetit të përbashkët të gjitha të dhënat e përfuara do shërbejnë për përditësimi e hartave për Portin e Sarandës.



133 djem e vajza nisën stërvitjen individuale bazë

Pas përfundimit të stërvitjes, rekrutët do të betohen dhe më pas do të shërbejnë në repartet e FA

Më 23 shtator, 133 vajza e djem nisën stërvitjen individuale bazë, e cila është porta hyrëse për në Forcat tona të Armatosura. Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka njofton se "për 10 javë, këta djem e vajza do të sprovajnë veten fizikisht e psikologjikisht përpara se të jenë plotësisht të përgatitur dhe të denjë për të shërbyer nën uniformë".

Sipas ministres së Mbrojtjes, stërvitja po zhvillohet në Bunavi. "133 vajza e djem nisën stërvitjen individuale bazë në Bunavi, e cila është porta hyrëse për në Forcat tona të Armatosura. Për 10 javë, këta djem e vajza do të sprovajnë veten fizikisht e psikologjikisht përpara se të jenë plotësisht të përgatitur dhe të denjë për të shërbyer nën uniformë", thekson Xhaçka. Në këtë shtator, 133 djem dhe vajza nisën Stërvitjen Individuale Bazë (SIB) në Shkollën e Trupës Bunavi, pasi kaluan testimet fizike, psikologjike dhe intelektuale pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit.

Programi i Stërvitjes Individuale Bazë zgjat 10 javë dhe është e ndarë në 3 periudha: atë jeshile, blu dhe të kuqe, e cila konsiderohet edhe si periudha më e vështirë. Rekrutët e rinj u mirëpritën nga komandanti i Shkollës së Trupës, kolonel Ardian



Lulaj, përpara se të njiheshin me programin, rregullat dhe oraret nga instruktorët e shkollës. Mes rekrutëve të ardhur nga të gjitha krahinat e Republikës së Shqipërisë, janë edhe

12 vajza. Pas përfundimit me sukses të kësaj stërvitjeje intensive, rekrutët do të betohen dhe më pas do të shërbejnë në reparte të ndryshme të Forcave të Armatosura.

Në ambientet e Shkollës së Trupës në datë 04.09.2019 u zhvillua ceremonia e promovimit në gradë të oficerëve dhe nënoficerëve të cilët u vlerësuan gjatë këtij viti nga ana e komisioneve të karrierës. Në ceremoninë e zhvilluar morën pjesë Komandanti, shtabi, drejtues të strukturave dhe personeli i Shkollës së Trupës.

Për arritjet dhe rezultatet e larta, performancën që ky personel ka prezantuar, shpërblehen me gradën e radhës dhe mundëson vijueshmërinë e mëtejshme në karrierën ushtarake duke e shoqëruar me detyra më të rëndësishme në Shkollën e Trupës dhe në struktura të tjera të Forcave të Armatosura. Komandanti i Shkollës së Trupës Kolonel Ardian Lulaj uroi të sapo graduarit dhe theksoi se ky është shpërblimi i punës, mundit e sakrificave tuaja gjatë këtyre viteve, prandaj kërkoj nga secili nga ju të tregoni profesionalizëm dhe përkushtim në realizimin e misionit të Shkollës së Trupës.

Promovohen në gradë oficerë dhe nënoficerë



Të premten, më 20 shtator 2019 është festuar, 61-Vjetori i Krijimit të Brigadës së Nëndetëseve. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, zëvendëskomandanti i Forcës Detare, drejtorë në Shtabin e Përgjithshëm, prefekti i Qarkut Durrës, ish-komandantë, veteranë e ish-lundruar, të cilët kanë shërbyer ndër vite në nëndetëse si dhe efektiva të FD. Në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni, gjeneral brigade Kollçaku u shpreh: "Kam nderin dhe kënaqësinë që me rastin e 61- Vjetorit të Krijimit të Brigadës së Nëndetëseve të jem mes jush për të përshëndetur, respektuar dhe shprehur mirënjohjen për të gjithë ish-efektivët dhe komandantët e Brigadës së Nëndetëseve, të cilët me përkushtim, djersë dhe sakrifica, për më shumë se 40 vjet bën krenarë Forcat e Armatosura duke kryer një nga detyrat më të vështira të mbrojtjes së vendit."

Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneral brigade Kollçaku, solli në vëmendje përfaqësues të nderuar që kanë shërbyer në armën e nëndetëseve. "Të gjithë ata që kanë shërbyer në Armën e Nëndetëseve janë dhe do të mbeten të vlerësuar, nderuar e respektuar prandaj në shprehje të mirënjohjes tonë, do të kujtoja këtu disa nga emërat përfaqësues të kësaj arme të nderuar, të tillë si komandantët e parë të brigadës dhe të nëndetësve të saj: Xhemal Shani, Dashamir Ohri, Muharrem Lulollu, Spiro Kote, dhe Shyqyri Cukaj. Këta burra, me vizion të qartë, aftësi, guxim dhe sakrificë, komanduan dhe

61- Vjetori i Brigadës së Nëndetëseve

Modernizimi i FD në përputhje me konceptin e ri të NATO-s

Brigada e Nëndetëseve u krijua më 17 shtator 1958 dhe ka funksionuar deri në fund të vitit 1998



drejtuar efektivat e tyre, përballuan të gjitha vështirësitë e punës dhe të shërbimit, duke treguar zotësi në kryerjen e detyrave të vështira dhe specifike të kësaj arme si dhe duke trashëguar vazhdimësinë në brezat e ardhshëm. Këto eksperiencia dhe kontribute janë frymëzim edhe për efektivat e sotëm të Forcës Detare dhe jo vetëm.

Në përfundim të fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku vlerësoi transformimin dhe modernizimin e Forcës Detare në përputhje me konceptin e ri të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit si anëtar i NATO dhe kandidat i BE.

"Forca Detare është e angazhuar dhe kontribuon në misione dhe

detyra brenda dhe jashtë vendit, sikurse është angazhimi në misionin e NATO në Detin Egje, zbatimin e ligjëshmërisë në det, etj. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm kanë plane të qarta afatshkurtëra dhe afatgjata për zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të Forcës Detare.

Edhe njëherë, respekt dhe mirënjohje për kontributin e atyre, që unë do ti quaja veteranët tanë të nderuar, të cilët jo vetëm shërbyen dhe ja kushtuan jetën Armës së Nëndetëseve, por edhe sot janë pranë nesh dhe mbështesin përpjekjet tona të përbashkëta.", u shpreh gjeneral brigade Kollçaku. Në emër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe zëvendëskomandantit të Forcës Detare për ish-nënujësuar u dhanë medalje dhe certifikata mirënjohje për kontributin e dhënë ndër vite. Brigada e Nëndetëseve u krijua më 17 shtator 1958 dhe shërbeu deri në fund të vitit 1998. Gjatë asaj periudhe ajo kreu misione dhe detyra luftarake speciale për kohën duke e bërë atë një ndër njësitë më të rëndësishme të Forcave të Armatosura.

Në Forcën Detare

Gradohen 26 oficerë dhe 8 nënoficerë

Paraditen e ditës së martë, më 10 shtator, në Komandën e Forcës Detare dhe reparteve të saj, u zhvillua ceremonia për dhënien e gradave të reja, oficerë dhe nënoficerë, ku mori pjesë zëvendëskomandanti dhe kadro të shtabit dhe reparteve të Forcës.

Në komandën e Forcës Detare personeli i graduar u përshëndet nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Artur Meçollari, hapi ceremoninë duke

uruar efektivat për arritjet e tyre, të cilat, siç tha ai "Janë rezultat i punës tuaj të vazhdueshme disa vjeçare". Ai shtoi më tej "Unë uroj, që ky promovim juaji sot të pasohet nga të tjerë në vitet pasi karriera juaj do të vazhdojë. Forca Detare u është mirënjohëse për punën dhe shërbimin tuaj".

Gjithashtu dhe në Flotiljen Detare Pashaliman, u zhvillua ceremonia për dhënien e gradave, e cila u përshëndet nga koman-

danti, kapiten I rangut I Adnan Agastra, duke iu uruar suksese të mëtejshme personelit të graduar. Ceremonia vijoi me leximin e urdhrit të ministrit të Mbrojtjes dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura mbi gradimet e reja dhe më pas në mënyrë simbolike komandantët e reparteve vunë gradat e reja në supet e të sapo promovuarve. Në total në Forcën Detare, morën gradën e radhës 26 oficerë, 8 nënoficerë.

Kapiteni i rangut I Joachim Brune, komandant i grupit të anijeve TU 01 të Standing NATO Maritime Group Two (SNMG2), i cili drejton aktivitetin e NATO në detin Egje, njëkohësisht dhe operacionin e këtyre anijeve në këtë rajon, zhvilloi një vizitë në vendin tonë. Fillimisht kapiteni dhe ekipi i tij zhvilluan një vizitë në Shtabin e Përgjithshëm të FA e më pas në Komandën e Forcës Detare. Gjatë pritjes të organizuar në Komandën e FD, zëvendëskomandanti i kësaj force, kapiteni i rangut I Artur Meçollari, i uroi mirëseardhjen kapiten Brune dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me grupin SNMG2 në detin Egje, ku operon dhe anija jonë "Oriku" në kuadër të operacionit "Sea Guardian". Ndërkohë z. Joachim Brune, falënderoi zëvendëskomandantin e FD për pjesëmarrjen e Forcës sonë Detare në këtë operacion të rëndësishëm, si dhe kontributin që po japin detarët tanë në këtë operacion, ku kanë treguar aftësi, përkushtim e profesionalizëm të

Komandanti i SNMG2 viziton Komandën e Forcës Detare

Do rritet bashkëpunimi me grupin SNMG2, në stërvitje dhe operacione të përbashkëta

lartë gjatë zbatimit të detyrave e misionit të tyre. Gjithashtu pjesë e bisedës ishte thellimi i bashkëpunimit në të ardhmen midis Forcës Detare shqiptare dhe grupit SNMG2, sidomos në trajnime, vizita portuale, stërvitje e operacione të përbashkëta.



FORCA DETARE

Stërvitja e koduar "Antindotja 2019"

Zhvillohet konferencë planëzuese për reagimin ndaj ndotjes detare

Me date 2 shtator 2019, në Komandën e Forcës Detare u zhvillua konferenca planëzuese për reagimin ndaj ndotjeve detare. Në Konferencë morën pjesë quadro të shtabit dhe flotiljes të Forcës Detare që do organizojnë dhe zhvillojnë këtë stërvitje, gjithashtu dhe përfaqësues e specialist të institucioneve tona shtetërore, që mbulojnë mjedisin detar, konkretisht, QNOD, Prefektura, Bashkia, Drejtoria e Përgjithëshme Detare, Autoriteti Portual Durrës, Policia Kufitare, Agjencia e Zonave të Mbrojtura dhe UNDP ALBANIA, e cila inicion projekte për mjedisin detar.

Stërvitja e koduar "Antindotja-2019" do zhvillohet në dy faza, fillimisht në gjirin e Vlorës dhe pastaj në Portin e Durrësit. Qëllimi i saj është: evidentimi i gatishmërisë së kapaciteteve reaguese të FD-së ndaj ndotjes detare si dhe testimi i komandim-kontrollit në nivel taktik. Zv/ Komandanti i Forcës Detare, Kapiteni i Rangut të I-rë, Artur Mecollari, theksoi rëndësinë e kësaj stërvitje dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me institucionet shtetërore dhe UNDP ALBANIA për parandalimin dhe eliminimin e ndotjeve detare në hapësirën tone detare.



Vetëm në pak ditë anija "Oriku" shpëton 140 emigrantë në detin Egje. Keshtu në 2 shtator, ditën e martë, në orët e para të mëngjesit, anija Oriku, e cila është me mision në detin Egje ka diktuar në zonën e patrullimit, një gomone me emigrantë në bord. Më pas është bërë shoqërimi i saj tek Roja Bregdetare turke, e cila bëri edhe procedurat e imbarkimit për t'i dorëzuar autoriteteve vendase. Në gomone ndodheshin 25 emigrantë, prej të cilëve 5 gra, 5 fëmijë (4 fëmijë dhe 1 foshnjë) dhe 15 burra me kombësi afgane.

Një ditë më e pas anija "Oriku" P-132 me mision në detin "Egje", pjesë e operacionit të NATO "Sea Guardian", në patrullim gjatë orëve të para të mëngjesit të datës 3 shtator 2019 ka zbuluar një gomone me 34 emigrantë afganë, e cila iu dorëzua Rojes Bregdetare turke, duke bërë të mundur shpëtimin e jetëve të tyre. Gjithashtu, në bashkëpunim me Rojen Bregdetare turke dhe greke, anija "Oriku" P-132 ka asistuar në ndalimin dhe shpëtimin e jetëve të një gomone tjetër me rreth 45 emigrantë sirianë. Mes emigrantëve të shpëtuar ka patur një numër të konsiderueshëm grash dhe fëmi-

Anija "Oriku" shpëton 140 emigrantë në detin Egje



jësh. Ditën e mercurit anija "Oriku" P-132 ka ndaluar një gomone tjetër me 36 emigrantë në bord.

Pra në vetëm 3 ditë janë ndaluar 4 gomone të ndryshme me rreth 140 emigrantë afganë e sirianë në bord, gjysma e të cilëve gra e

fëmijë që rrezikojnë jetën në ujërat mes Turqisë e Greqisë. Që prej vitit 2016, kur Shqipëria u bë pjesë e misionit të NATO në detin Egje, janë mbi 2.000 fëmijë, gra e burra të shpëtuar nga djemtë tanë të Forcës Detare.


BASHKËPUNIM ME ANIJEN "SAN MARKO"

Më datë 18 shtator 2019, pjesëtarë të Grupit të bordimit të Forcës sonë Detare zhvilluan një stërvitje reale në gjirin e Durrësit. Tematika e stërvitjes ishte kapja dhe izolimi i një grupi terrorist që ka marrë peng anijen, ose bordimjokonsensual, sic quhet në gjuhën teknike.

Përmes gjysëm ore djemtë tanë nëpërmjet veprimeve të shpejta, të shkathta dhe korrekte arritën të izolojnë terroristët që kishin marrë peng anijen. Stërvitja u zhvillua në bordin e anijes "LISSUS", e cila në këtë rast imitonte anijen "viktimë".

Veprimet u ndoqën nga specialistët e FD dhe ushtarakë italianë të grupit trajnues të anijes "SAN MARKO". Në fund të stërvitjes u nxorrën konkluzione dhe shkëmbyen mendime midis personelit të grupit

Grupi i bordimit i Forcës Detare në stërvitjen e radhës



tone të bordimit dhe ekspertëve italo-alianë. Këta të fundit vlerësuan pozitivisht shumicën e veprimeve të

kryera dhe përgëzuan pjesëmarrësit për veprimet e kryera në cdo fazë të operacionit.

Mbrojtja dhe rezoluta 1325 e OKB “Për gruan, Paqen dhe Sigurinë”

Në Komandën e Forcës Ajrore, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Manushaqe Shehu, zhvilloi më 24 shtator, një takim pune me personelin gra dhe vajza (ushtarak dhe civil) të strukturave vartëse të Forcës Ajrore. Qëllimi i takimit ishte njohja me Planin e Veprimit Kombëtar dhe të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e rezolutës 1325 të OKB “Për gruan, Paqen dhe Sigurinë”. Në këtë takim gjeneral brigade Manushaqe Shehu u shoqërua nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Editson Zarka. Gjeneral brigade Shehu gjatë fjalës së saj, pasi falënderoi pjesëmarrëset në këtë takim vuri theksin në rëndësinë që ka roli i gruas në Forcat e Armatosura: “Gratë janë një forcë e



konsiderueshme dhe aset i çmuar për rolin dhe vendin që kanë në realizimin e misionit të Forcave të Armatosura. Jeni ju që me kontributin tuaj merrni pjesë dhe shërbeni në misione të rëndësishme siç është ai i OKB-së (Sudan), si dhe në misione të tjera të rëndësishme përkrah aleatëve tanë në NATO”. Më tej, gjeneral brigade Shehu duke u ndalur në zbatimin e rezolutës 1325 të OKB “Për gruan, Paqen dhe Sigurinë” u shpreh ndër të tjera se: “Shekulli i 21 është quajtur Shekulli i Gruas, muaji tetor është 19-vjetori i rezolutës 1325 të OKB në të cilën është dhënë një rëndësi e madhe rolit të gruas në vendimmarrje”. Nga gratë pjesëmarrëse në takim u diskutua dhe u shkëmbyen mendime nga eksperiencat gjatë detyrave të kryera në Forcat e Armatosura.

Nga gjeneral brigade MANUSHAQE SHEHU
Zëvendëshefe e Shtabit të Përgjithshëm

Jam e privilegjuar që, sot në cilësinë e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, por edhe si femër, si grua, si motër dhe si nënë, të zhvillojë këtë takim me ju, ku të ndajmë mendime së bashku për rolin e femrës në FA.

Qëllimi i këtij takimi është: E para të takohemi të gjitha së bashku, pasi veç e veç me secilën takohemi shpesh për arsye pune, por edhe shoqërore. Pjesëmarrëse sot në këtë takim janë të gjitha femrat që punojnë në Bazën e Ajrore Rinas. Në takime të tjera mund të jemi edhe më shumë. E dyta, për t'u njohur diçka më shumë me Rezolutën 1325 të Këshillit të Kombeve të Bashkuara “Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë” dhe të gjitha dokumentet e tjera të dalë për këtë qëllim. E treta, të ndajmë së bashku mendime e probleme që sot ju shqetësojnë në punën e përditshme, në mënyrë krejt të lirshme, larg çdo lloj zyrtarizmi, pse jo edhe ndonjë problem tjetër që ju do ta konsideroni të nevojshëm. Pra takimin e sotëm do ta konsideroja një bashkëbisedim të lirë me koleget ushtarake e civile që punojnë në FAj ashtu siç kam kryer takime të tilla me gratë e SHPPFA, KDS, FT dhe në vijim edhe me strukturat e tjera të FA. Femra shqiptare, aq më tepër femrat ushtarake, por edhe ato civile që punojnë në Forcat e Armatosura, janë një forcë e vlerësuar në tërë jetën politike, ekonomike, arsimore, ushtarake e në shumë fusha të rëndësishme të jetës së vendit. Shembujt e femrave që kanë bërë dhe bëjnë karrierë të suksesshme dhe mjaft të vlerësuar e të spikatur në jetën e vendit ka me qindra, ashtu siç ka edhe mjaft femra ushtarake po me karrierë të suksesshme, në çdo pozicion që i është dhënë mundësia të kontribuojë në zhvillimin e FA. Gjej rastin t'ju falënderojë secilën femër në veçanti për kontributin e dhënë dhe që vijoni të jepni. Edhe në detyrat e mëparshme që kam kryer, kam ndjekur në vazhdimësi problemin e zbatimit të rezolutës 1325 në FA. Për këtë kam marrë pjesë në shumë aktivitete brenda e jashtë vendit, ku kam ngritur me forcë zërin që sot femrës ushtarake në FA t'i jepet me dinjitet vendi dhe roli që i takon.

Disa dokumente të miratuara në zbatim të rezolutës 1325

Me urdhër të Ministrisë së Mbrojtjes unë kam qenë në krye të një grupi pune që ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rezolutës, ku pjesë e këtij grupi

“Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë”

Rritja e përfaqësimit të grave në Forcat e Armatosura



mund të ketë qenë edhe dikush prej jush që ndodheni sot në këtë takim. Sa për dijeni Ministrija e Mbrojtjes, më parë zonja Kodheli dhe aktualisht zonja Xhaçka, kanë qenë dhe janë mbështetës kryesore të këtij procesi. Gjithashtu dua të theksoj edhe mbështetjen që jep në këtë drejtim Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Kollçaku. Sot kemi të miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes “Planin e Veprimit të Barazisë Gjimore në FA 2018-2020”. Po kështu kemi të miratuar VKM nr. 524, datë 11.09.2018 “Planin e Veprimit të Barazisë Gjimore në shkallë kombëtare”. Në të dyja këto dokumente që janë në zbatim dhe mbështetje të Rezolutës 1325, janë parashikuar një sere masash, të cilat bëjnë të mundur mbështetjen dhe dhënien e rolit qëi takon gruas në jetën ushtarake. Është detyrë e juaja dhe të gjitha institucioneve për të kërkuar me forcë dhe kuroje zbatimin e tyre.

Në planin e veprimit janë parashikuar shumë masa, ku mund të theksonim:

1. Masat për rritjen e përfaqësimit të grave në FA, ku janë parashikuar masa për përmirësimin e akteve ligjore si: rishikimin e Strategjisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Rishikimin e udhëzimit për politikën dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë, nënoficerë, ushtarë profesionist, ku femrat të

kenë përqindjen e tyre. Hartimin e dokumentit “Politika dhe procedura e trajtimit të rasteve të ngacmimit seksual në FA”. Marrje eksperience në vendet e NATO-s. Organizimi i takimeve, seminareve dhe workshopeve për njohjen e akteve ligjore e nënligjore të barazisë gjimore.

2. Fuqizimi dhe rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimmarrje dhe promovimi i tyre në detyra komanduese. Promovimi i ushtarakeve femra në pozicione komanduese në të gjitha nivelet. Aktualisht nuk kemi një ushtarake komandante batalioni a njësie. Evidentim dhe promovim iliderëve të ardhshme në nivel hierarkie. Promovim të femrave në pozicione pedagogu në AFA dhe instruktor në ANO. Përfaqësimi i femrave në komisionet e karrierës. Rishikim i strukturave të misioneve për vendosjen pranë komandantëve të këshilltareve gjimore. Rishikim i TOP-it për vendosjen e funksionit të specialistit të barazisë gjimore në rang force. Rritja e përfaqësimit të femrave në shtabet e NATO-s dhe në misione jashtë vendit. Emërimi i personelit femër në detyrën e Atasheut Ushtarak. Dhënien përparësi të rolit të femrave në pozicionet organike të BCU, mjekësisë, logjistikës, financës, PU, etj. Më tepër prezencë në strukturat të komponentit rezervist në QPR. Përparësi në dhënien e fletëve të kampit e të medaljeve. Përparësi në dhënien

e kredive për strehim. Mundësi në përmirësimin e uniformës ushtarake të femrave. Mbi mundësinë e hapjes së çerdhes për fëmijët e ushtarakeve në Garnizonin “Skënderbej”, por edhe në forca. Vizita mjekësore, mamografi falas, hapja e një rubrike në websajtin e MM për denoncimin e rasteve të ngacmimeve seksuale apo edhe videntimin e ngacmimeve seksuale, etj. Po kështu në Planin e veprimit ka një sërë masash për propagandimin e rolit të femrave në FA në median e shkruar dhe vizive.

Si është sot gjendja e femrave në FA?

Nga të dhënat e nxjerra nga DBNJ në MM rezultojnë se për vitin 2019 deri në këtë periudhë në rang FA kemi 1373 femra, ose 17.5% të FA, nga këto 537 janë civile dhe 836 janë ushtarake ose 13.55 % të numrit të përgjithshëm të të FA. Pjesëmarrja e femrave në misione paqeruajtëse, tashmë nuk është më një tabu. Nga Forca Ajrore për here te pare keni një femër ushtarake me mision në Sudanin e Jugut. Si Force e Armatosur vetëm gjatë vitit 2018 kanë marrë pjesë në misione 8 femra ose 3.9%, konkretisht: 2 në Detin Egje, 3 Afganistan, 1 Kosovë dhe 2 Letoni. Gjatë vitit 2018 janë emëruar në përfaqësi ushtarake jashtë vendit 5 femra, ose 6.8%. Gjatë vitit 2018 kanë marrë pjesë në trajnime e kurse kualifikimi 60 femra, ose 4.8%. Ju referuam këtyre shifrave për të parë se si ka ndryshuar në fakt pjesëmarrja e femrave në të gjitha aktivitetet e FA brenda e jashtë vendit. Siç shikohet kemi ndryshime të dukshme. A mjafton me kaq? Sigurisht që Jo.

Atëherë çfarë kërkohet nga vetë ne si femra?

Rritja e ndërgjegjësimit tonë që vlejme shumë më tepër, rritja e kualifikimit dhe vetëzhvillimit, njohja e gjuhës së huaj, rritja e aftësive fizike, rritja e pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme të barazisë gjimore, rritja e kërkesës ndaj eprorëve kushdo qofshin për zbatimin në praktikë të Planit të Veprimit të miratuar dhe mos nënshtrimi ndaj askujt dhe për asgjë. Unë këto probleme mendova të ndaj me ju në këtë takim. Patjetër që ka edhe probleme të tjera. Le t'i japim të gjitha së bashku një shtytje të mëtejshme rritjes së rolit të femrës në Forcën Ajrore dhe në FA.

Mbajtur në takimin me personelin gra dhe vajza, ushtarake dhe civile të Forcës Ajrore



Në Ministrinë e Mbrojtjes z. Faruk Geci, ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe z. Christian Heldt, ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë nënshkruan Marrëveshje, me anë të së cilës Qeveria gjermane ndan një grand me vlerë 500,000 euro (pesëqind mijë euro) për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për blerjen e materialeve dhe pajisjeve mjekësore.

Me këtë rasat, sekretari i përgjithshëm z. Geci ka falënderuar ambasadorin gjerman z. Heldt dhe përmes tij Qeverinë dhe popullin gjerman për ndarjen e mjeteve financiare për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht për shërbimin mjekësor të FSK-së, si dhe për mbështetjen e vazhdueshme që Ministria e Mbrojtjes e Gjermanisë është duke dhënë për ndërtimin e kapacitetet të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Forca e Sigurisë e Kosovës, me fondin e dhuruar nga Qeveria gjermane, ka për qëllim të përmirësojë pajisjet e Qendrës Mjekësore të Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe synon të sigurojë materiale dhe pajisje mjekësore që do të ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve mjekësore dhe shërbimeve mjekësore në FSK. Ministria e Mbrojtjes e Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes e Gjermanisë kanë marrëdhënie shumë të mira dypalëshe.



QENDRA MJEKËSORE E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS Gjermania: 500.000 euro FSK-së për blerjen e paisjeve mjekësore

Mbretëria e Bashkuar do mbështesë FSK-në dhe QTKSH-në

Ambasadori i Britanisë së Madhe në Republikën e Kosovës, z. Nicholas Abbott, vizitoi më 17 shtator, Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në kazermën „Evropianët e Rijnë“ në Pomozatin, me ç’rast u mirëprit nga shefi i Shtabit i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), nënkolonel Shpend Zogaj, i cili e njoftoi atë me të arriturat e përgjithshme të këtij regjimenti si dhe vizionin për të ardhmen. Ambasadori Abbot, gjatë kësaj vizite takoi studentët pjesëmarrës të trajnimit „Menaxhimi i Rrezikut nga Trauma“ (TRiM), si dhe vizitoi objektet e QTKSH-së: kornizën e helikopterit; vagonët e trenit; ndërtesat e shembura dhe gjysmë të shembura; zonën e përplasjes masive të trafikut dhe kullën e lartë të ushtrimeve. Ambasadori i Britanisë së Madhe, z. Abbot, gjatë vizitës së tij, nga shefi i qendrës së trajnimit u informua rreth planeve për ndërtimin e infrastrukturës së QTKSH-së, për ta bërë një qendër të kompletuar për trajnime të kërkim-shpëtimit, jo vetëm për pjesëtarët e FSK-së, por edhe të rajonit dhe më gjerë. Nga ana e tij, ambasadori Abbot, vlerësoi QTKSH-në, për gjithçka që ka arritur deri me tash dhe veçanërisht për vizionin e saj për të ardhmen. Ai gjithashtu premtoi vazhdimin e mbështetjes së Mbretërisë së Bashkuar për FSK-në dhe QTKSH-në.



FSK bashkëpunon me Komandën e Ushtrisë Amerikane për Evropën

Komandanti i FSK-së gjeneralletenant Rrahman Rama, priti gjeneral brigade John H. Phillips, zv.shëf i Departamentit të Komunikimit (G6) në kuadër të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Rrahman Rama, priti më 17 shtator në vizitë në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneral brigade John H. Phillips, zëvendës shef i Departamentit të Komunikimit (G6) në kuadër të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë.

Në takimin e përbashkët, komandanti i FSK-së dhe gjenerali amerikan, biseduan për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Kosovës dhe SHBA-ve, përkatësisht Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë, në fusha konkrete dhe bashkëpunime të frytshme.

Me këtë rast, gjeneral Rama vlerësoi lart rolin e trupave ushtarake amerikane në kuadër të KFOR-it, marrëdhëniet dypalëshe me Gardën Kombëtare të Ajoves, donacionet e pareshtura të Qeverisë dhe popullit amerikan për zhvillimin dhe profesionalizimin e FSK-së dhe ngritjen e kapaciteteve të saj. Gjatë takimit të dy gjeneralët biseduan edhe për sigurinë kibernetike, shkëmbimin e përvojave në mes dy ushtrive dhe në veçanti folën për objektivat e FSK-së dhe të Kosovës për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të fushës kibernetike, funksionalizimin e sistemit të sigurisë kibernetike në përballje me kërcënimet eventuale si në vend, ashtu edhe në rajon dhe me gjerë, bashkëpunimin me shtetet mike dhe partnere etj.

Gjenerali Phillips se bashku me stafin e tij vizitoi edhe Kompaninë e Komunikimit, ku u mirëprit nga komandanti i kësaj kompanie, kapiten Fatmir Kajtazi, i cili pasi e falënderoi për vizitën, e njoftoi në pika të shkurtra rreth detyrave,



pajisjeve dhe misionit të kompanisë që ai drejton. Më pas, të gjithë se bashku ndoqën trajnimet e pjesëtarëve të FSK-së, në fushën e

IT-së ("Cyber TCT") dhe në fushën e radiosistemeve, të cilat janë duke u realizuar falë bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Ajoves.

FSK-ja në kampin ndërkombëtar të nënoficerëve

Nga data 29 gusht deri më 6 shtator 2019, u zhvillua në Kroaci, "Kampi Veror Ndërkombëtar" i nënoficerëve, ku ishin të pranishëm ushtarakë nga vendet antare të NATO-s, por dhe nga vendet partnere. Si vend partner i NATO-s, Kosova u përfaqësua nga dy ushtarakë, në rang nënoficeri: konkretisht, kapter Xhevat Llumnica dhe kapter Shpresa Gashi. Kurse, rreshtermajori i FSK-së, Genc Metaj, mori pjesë në cilësinë e ligjëruesit, i cili më 30 gusht 2019 ka ligjëruar temën: „Udhëheqja dhe sfidat në udhëheqjen transformuese“. Ky është viti i katërt me radhë që FSK-ja merr pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare. Qëllimi i kampit është që të përgatitën nënoficerët e lartë me shkathtësi të udhëheqjes dhe funksioni i tyre në operacione ndërkombëtare.

“Tre oficerë të FSK së po marrin pjesë në Kampin Veror Nderkombëtar për vendet e NATO dhe PfP nga data 29 gusht deri më 6 shtator 2019 në Kroati. Kjo do të pajisë më tej anëtarët e FSK me aftësi drejtuese dhe do t'i përgatisë ata për misionet e ardhshme së bashku me aleatët e NATO-s”, shkruante Ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha në facebook.



BAZA AMERIKANE „HOHENFELS” E GJERMANISË

FSK në stërvitjen ndërkombëtare “Saber Junction 190, në Gjermani

Morën pjesë rreth 5400 trupa nga Armenia, Azerbajxhani, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Gjeorgjia, Italia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Polonia, Rumania, Turqia dhe Ukraina

Një kontingjent i Forcës së Sigurisë të Kosovës, i përbërë nga oficerë dhe nënoficerë, dy ekipe mjekësore dhe një ekip i Kompanisë për Operacione Civile (KOC), që nga 10-30 shtator mori pjesë në ushtrimin fushor ndërkombëtar „Saber Junction 190, i cili u realizua në bazën amerikane „Hohenfels” të Gjermanisë. Pjesëtarët e kontingjentit të FSK-së i ju bashkangjitën njërive amerikane, sipas misionit të tyre, duke operuar në detyrat e tyre specifike. Krahas Divizionit të Parë të Këmbësorisë së ushtrisë amerikane dhe asaj të Kosovës, në këtë ushtrim morën pjesë edhe mbi 5400 trupa nga shumë

vende të botës, si: Armenia, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Gjeorgjia, Italia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Polonia, Rumania, Turqia dhe Ukraina. Ekipet e mjekësisë të FSK-së u angazhuan në trajtimin e të lënduarve, evakuimin e viktimave dhe mbështetje të tjera mjekësore. Ndërsa, ushtarakët e KOC-it kanë duke realizuar operacione me civilët. Si njësi e re e krijuar, gjatë operacioneve të këtij

ushtrimi, u mbështetën vazhdimisht nga ekipet e specializuara në fushën e operacioneve civile të ushtrisë amerikane. Gjatë ushtrimit është mbajtur edhe DV-Day. Nga FSK-ja, stërvitjen e ndoqën kolonelët Agron Bajrami dhe Gyrner Murati. Stërvitja kishte për qëllim demonstrimin e aftësive dhe të gatishmërisë për të vepruar dhe punuar në një mjedis të kombinuar shumëkombësh, si dhe shkëmbimin e përvojave me shtetet partnere.





DSEI 2019 - PAVIJONI NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Gjeneral Rama në Panairin e Industrië Ushtarake

*Gjeneral Rama është takuar me general
Chris Tickel-drejtor i Aftësive në kuadër
të Ushtrisë Britanike dhe z. Robert Moore-
zëvendëskomandantin e Komandës së
Asistencës të Sigurisë të Ushtrisë Amerikane.*

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të organizatorit të Panairit Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes dhe Sigurisë Ndërkombëtare (DSEI), nga data 10 deri 13 shtator 2019, qëndroi për vizitë zyrtare në Londër.

Panairi i industrisë ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar konsiderohet si njëri ndër paniret më të mëdha në botë. Këtë vit u paraqitën dhe ekspozuan 934 kompani ndërkombëtare nga 110 vende të botës. Gjenerallejtënant Rrahman Rama, në kuadër të këtij panairi, ka mbajtur takime edhe me zëvendëskomandantin e Komandës së Asistencës të Sigurisë të Ushtrisë Amerikane, z. Robert Moore, ku së bashku kanë biseduar për shumë çështje të rëndësishme për FSK-në, si për procesin e tranzicionit, planet për ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive të reja mbrojtëse, si dhe për mbështetjen që Komanda e Asistencës së Sigurisë e Ushtrisë Amerikane do të mundë të ofrojë në të ardhmen për FSK-në.

Po ashtu, gjeneral Rama është

takuar edhe me gjeneral major Chris Tickel, drejtor i Aftësive në kuadër të Ushtrisë Britanike, të cilin, veç tjerash, e ka njoftuar lidhur me kapacitetet aktuale të FSK-së dhe integrimin e kapaciteteve të reja sipas planit gjithëpërfshirës të tranzicionit.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë takimit u shpreh se "FSK-ja po vazhdon ndërtimin e kapaciteteve profesionale ushtarake, bazuar në standardet më të larta, për t'i kontribuar sigurisë në bashkëveprim me partnerët e

saj strategjikë".

Panairi Ndërkombëtar i Industrisë së Mbrojtjes dhe Sigurisë Ndërkombëtare (DSEI) njihen si ekspozita më e madhe botërore, e detit, ajrit dhe të sigurisë. Aty bashkohen ekspertë të lartë ndërkombëtarë të tregtisë dhe ushtrisë nga e gjithë zinxhiri i furnizimit në një mjedis optimal biznesi. Në vitin 2019 pavijoni në Mbretërinë e Bashkuar ishte vendosur në një vend ideal në Sallën e Jugut përkrah Primes Britanike. Këtë vit DSEI feston vitin e 20-të.

Rumania një aleat i besuar i Maqedonisë së Veriut

Ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska, u takua më 11 shtator 2019, me homologun e saj rumun, ministrin e Mbrojtjes Kombëtare, Gabriel Benjamin Lesh, i cili qëndroi për vizitë zyrtare në Maqedonisë e Veriut. Ministrja Shekerinska tha pas takimit se Rumania ka dëshmuar mbështetjen për qëllimin tonë strategjik-anëtarësimin në NATO, pasi ajo ka përfunduar ratiifikimin e Protokollit të Anëtarësimin në NATO në një procedurë të shpejtë dhe e ka njohur vendin tonë si partner dhe aleat i cili ka kapacitete dhe njohuri për të kontribuar për paqen, stabilitetin dhe sigurinë e të gjitha vendeve anëtare të Aleancës.

"Mirëpo mbështetja e Rumanisë nuk ka qenë kurrë vetëm lidhur me NATO-n, por Qeveria Rumune ka qenë një nga mbështetësit më të fortë të qëllimit tonë strategjik, të fillojë negociatat me Bashkimin Evropian sa më shpejt që të jetë e mundur dhe unë do të doja të falënderoja në emër të Qeverisë sonë për atë mbështetje dhe të themi se në tetor presim të njëjtën gjë me optimizëm të shtuar dhe ambicie të shtuar", tha Shekerinska.

Ajo e vlerësoi bashkëpunimin midis dy ushtrive si të shkëlqyeshme dhe njoftoi bashkëpunimin shtesë në tre fusha-transferimin e përvojës rumune në misionet e udhëhequra nga BE në Afrikë, pastaj në modernizimin përmes kontratave qeveri me qeveri, dhe një segment të tretë dhe shumë të rëndësishëm jo vetëm për Armatën por edhe për ekonominë tonë, që është përvoja e Rumanisë dhe kompanive rumune në paraqitjen para partnerëve të NATO-s në tregjet e vendeve anëtare të NATO-s, sepse anëtarësimi në NATO nuk është vetëm siguri por edhe mundësi ekonomike.

Shekerinska veçoi simbolikën e Ditës 11 Shtator, përvjetorin e sulmit terrorist të Neë York-ut, kur Aleatët aktivizuan nenin 5 të

Maqedonia e Veriut dhe Rumania kanë bashkëpunuar në fushën e mbrojtjes që nga viti 1998, kur u nënshkrua Marrëveshje e Bashkëpunimit Ushtarak.



Traktatit të Uashingtonit. "Ne e mirëpresim ministrin pikërisht kur shënohen 18 vjet nga ngjarjet në New York që shënojnë për herë të parë që nga ekzistimi i NATO-s aktivizohet neni 5 i Traktatit të Uashingtonit dhe kur aleatët dhe anëtarët e NATO-s kanë pranuar se "Sulmi ndaj njërit është një sulm ndaj të gjithëve. Se siguria e njërit është e rëndësishme për të gjithë". Ne, si pjesë e Ballkanit, e dimë se kjo është e vërtetë, se nuk mund të ketë jostabilitet në fqinjësi, dhe që ne të jemi prosperues dhe të sigurt të dy vendet do të vazhdojmë të me një elan më të madh, tashmë si aleatë që jetojnë të njëjtat ideale dhe ide, lirinë, paqen dhe sigurinë e rajonit tonë, por edhe e kontinentit tonë", tha ministrja.

Ministri rumun Gabriel Benjamin Lesh përcolli urimet për hapat e suksesshëm drejt anëtarësimin në NATO dhe nënvizoi se Rumania gjithmonë do të jetë një mik dhe aleat i besueshëm i Republikës së Maqedonisë së Veriut. "Rumania ju

përcjell urime më të sigjerta me rastin e Ditës së Pavarësisë dhe për faktin që keni përmbyshur me sukses hapat për t'u anëtarësuar në NATO, aleanca më e fortë ushtarake politike në historinë botërore në të cilën së shpejti do të bëheni anëtar i 30-të me të drejta të plota që me siguri do të kontribuojë në përmirësimin e sigurisë së rajonit ballkanik. Unë gjithashtu ju siguroj në këtë mënyrë që vendi im do të jetë gjithnjë miku juaj dhe aleat i besueshëm", tha Benjamin Lesh.

Ai tha se Rumania ka mbështetur vazhdimisht përpjekjet e integritimit euro-atlantik të Maqedonisë e Veriut dhe shprehu kënaqësi për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit dypalësh në sektorin e mbrojtjes. Dy vendet kanë bashkëpunuar në fushën e mbrojtjes që nga viti 1998, kur u nënshkrua Marrëveshje e Bashkëpunimit Ushtarak. Që atëherë, janë mbajtur një numër i madh takimesh të niveleve të larta, trajnime të përbashkëta, kurse, ushtrime dhe takime ekspertësh.

MINISTRJA RADMILLA SHEKERINSKA NË ÇEKI

Maqedonia e Veriut, partner i ngushtë dhe i përherëshëm i Çekisë

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska ka zhvilluar më 21 shtator, vizitë zyrtare në Çeki ku u takua në qytetin çek Ostrava, me ministrin çek të Mbrojtjes Lubomir Metnar. Në takim u theksua bashkëpunimi i suksesshëm shymëvjeçar në Mbrojtje midis dy vendeve dhe mbështetjen e vazhdueshme për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO dhe për fillimin e negociatave me BE-ne. Ministrja Shekerinska falënderoi për ftesën për të qenë mysafire nderi në ngjarjen ndërkombëtare "Ditët e NATO-s" që filloi sot në Ostrava.

Shekerinska shprehu kënaqësinë që pala Çeke ratifikoi Protokollin e Pranimet në NATO javën e kaluar dhe tha se anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në Aleancë është një investim në sigurinë dhe stabilitetin e të gjithë rajonit. Bashkëpunimi i ngushtë midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ballkanit Perëndimor me vendet e Grupit të Vishegradit (V4) udhëheqësi i të cilit aktualisht është Republika Çeke është një shembull i shkëlqyeshëm se si vendet brenda një rajoni, por edhe midis rajoneve

duhet të bashkëpunojnë, theksoi ministrja.

"Republika e Maqedonisë së Veriut është një partner i ngushtë i përherëshëm i Çekisë në Ballkanin Perëndimor, dhe me anëtarësimin në NATO bëhet një lojtar i rëndësishëm për rajonin, si dhe për BE-në. Me ratifikimin e Protokollit dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme ju keni treguar se Republika Çeke vlerëson përparimin e arritur në vendin tonë dhe se respekti dhe bashkëpunimi i ndërsjellë do të vazhdojë edhe në të ardhmen brenda NATO-s, ku së shpejti do të bëhemi anëtarë të plotë", tha Shekerinska. Dy ministrat diskutuan gjithashtu dhurimin e pajisjeve për ushtrinë maqedonase nga Republika Çeke si

dhe Nismën Austriake për Akademinë Ushtarake Rajonale dhe angazhimin austriak për të pasur një seli në Shkup, për të cilën pala çeke shpreh përkrahje të plotë. Takimi ministror u mbajt në margjinat e manifestimit ndërkombëtar "Ditët e NATO-s", nikoqir i të cilit tradicionalisht është qyteti çek Ostrava, dhe në hapjen solemne morri pjesë ministrja Shekerinska së bashku me ministrat e mbrojtjes të V4- Republika Çeke, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia. Kjo ekspozitë më e madhe e mbrojtjes dhe e sigurisë bashkon 18 vende të NATO-s dhe Partnerëve të cilat shfaqin përparimet më të fundit teknologjike në pajisjet e tyre ushtarake dhe policore.



Ministrja Shekerinska në Qendrën për Trajnimin e Pilotëve

60 pilotë polakë në Qendrën për Trajnimin e Pilotëve

Ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska, bashkë me ambasadorin e Republikës së Polonisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Wojcieh Ticinjski vizitoi Qendrën për Trajnimin e Pilotëve në kazermën „Strasho Pinxhur“ në Petrovec. Gjatë kësaj vizite, ministrja Shekerinska dhe ambasadori Ticinjski patën mundësi të ndjekin fillimin e trajnimit të brezit të ri të nëntë të kandidatëve për pilotë ushtarak, si dhe trajnimin për pilotët ushtarak polak të cilët stërviten në simulatorin MI24. Ministrja Shekerinska në një deklaratë për mediat shpalosi dy lajme të mira:

„Lajmi i parë i mirë është se grupi i ri i kadetëve të cilët përgatiten për t'u bërë pilotë ka filluar me trajnimin dhe për herë të parë pas kaq vitesh së funksionimit të Qendrës për Trajnimin e Pilotëve kemi zgjidhur një nga problemet e tyre ekzistenciale, e kjo nënkupton se përdërisa janë duke u shkolluar, ata do të marrin rrogë. Shpresojmë që kjo fillimisht do t'ua përmirësojë jetën, do t'ua ris cilësinë e arsimit, por gjithashtu do të nxis edhe të tjerët më lehtë t'i bashkohen këtij procesit. Lajmi i dytë i mirë është se Qendra e Trajnimit të Pilotëve ka fituar një repu-

*Ambasadori polak Wojcieh Ticinjski:
“Bashkëpunimi midis Polonisë dhe
Maqedonisë së Veriut në fushën e
mbrojtjes është intensiv dhe po zhvillohet”*

tacioni ndërkombëtar dhe unë jam e kënaqur që sot dhe në këto gjashtë javë, pothuajse 60 pilotë të ushtrisë polake do të marrin trajnime në simulatorë në Qendrën tonë për Trajnimin e Pilotëve. Gjithashtu, në periudhën që e ardhmes 30 pilotët të tjerë të ushtrisë bullgare do të bëjnë të njëjtën gjë dhe kjo tregon se Republika e Maqedonisë së Veriut si anëtare e ardhshme e NATO-s tashmë ka cilësi dhe diturinë që mund t'ua ofrojë Aleatëve,” tha Shekerinska.

Shekerinska u bëri thirrje të rinjve me interes për këtë profesion që të aplikojnë në konkursin e

tetorit. „Tashmë në fillim të tetorit po fillojmë një konkurs të ri dhe me të vërtetë u bëj thirrje të gjithë të rinjve që kanë pasion, të cilëve fluturimi iu duket një profesion atraktiv, të aplikojnë, të kalojnë ndoshta testet e vështira, por të kenë kënaqësinë të jenë pjesë e njërës nga njësitë elitare në Armatën tonë”, tha ministrja. Ambasadori polak Wojcieh Ticinjski tha se bashkëpunimi i mbrojtjes midis dy vendeve është intensiv dhe po zhvillohet. Në Qendrën e Trajnimit të Pilotëve ai pati mundësinë të ndiqte dimensionin praktik dhe trajnimin e pilotëve ushtarakë polak.





RADMILLA SHEKERINSKA- KARL ERJAVEC

Slovenia mbështetje Maqedonisë së Veriut për integrim në NATO

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska pati një takim me homologun e tij sloven Karl Erjavec në Bled. Takimi riafirmoi miqësinë e sigurtë midis dy vendeve, bashkëpunimin e suksesshëm të mbrojtjes dhe mbështetjen aktive që Sllovenia i jep Maqedonisë së Veriut në të gjitha fazat e përparimit drejt integritit në NATO dhe BE. Sllovenia ratifikoi protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë veriore në NATO menjëherë pas Greqisë dhe ishte një sinjal pozitiv për rajonin dhe vendet e tjera anëtare. Tani procesi është në përfundim. Dhe sinjalet e BE për hapjen e negociatave në tetor janë positive-tha ministrja dhe falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme të Sllovenisë. Ministri Slloven i Mbrojtjes Karl Erjavec shprehu

shpresë se anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO do të hapë rrugën e anëtarësimin në BE.

"Ratifikimi i shpejtë i protokollit është dëshmi e miqësisë sonë të sigurtë. Shpresoj se në Samitin e NATO-s në dhjetor, Maqedonia e Veriut do të jetë një anëtare e plotë, ndërsa kjo do t'i hapë rrugën anëtarësimin në BE. Kështu ishte me Slloveninë. Jam i bindur që BE do të hapë shumë mundësi për zhvillimin e vendit",

tha Erjavec dhe përsëri ofroi mbështetjen e vendit të tij në çdo hap të rrugës. Dy ministrat ranë dakord për bashkëpunimin e zgjeruar të mbrojtjes dhe ndihmën e ekspertëve në reformat e sektorit të mbrojtjes në përputhje me standardet e NATO-s. Ky takim u zhvillua në margjinat e Forumit Strategjik të Bledit ku ministrja Shekerinska foli këtë mëngjes në panelin në temë-"E ardhmja e Aleancës, 70 vjet pas Traktatit të Uashingtonit".

Ministri i Mbrojtjes Predrag Boskoviç u takua me Ambasadorin e Republikës së Italisë në Mal të Zi, Luka Zelioli, i cili u shoqërua nga Atasheu i Mbrojtjes i sapoemëruar italian në Mal të Zi, mbi baza jorezidente, kolonel Ciro Forte dhe Kolonel Paolo Sfare, i cili u largua nga ai post. Ministri përgëzoi Kolonel Forte për emërimin e tij në postin e ri, duke shprehur shpresën se bashkëpunimi i jashtëzakonshëm midis dy ministrive deri më tani do të përmirësohej më tej gjatë mandatit të tij.

Boskoviç shprehu mirënjohje për mbështetjen e gjithanshme dhe të vazhdueshme të Italisë për Malin e Zi, si në fushën e reformës mbrojtëse që rezultoi në anëtarësim në Aleancë dhe në fushën e integritit në Bashkimin Evropian.

Boskoviç theksoi se Mali i Zi do të vazhdojë të promovojë fuqishëm politikën e dyerve të hapura të NATO-s, duke theksuar se integrimi në NATO dhe BE për Ballkanin Perëndimor është një parakusht absolut për krijimin e paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm. Ai e informoi bashkëbiseduesin për përparësitë aktuale të mbrojtjes në lidhje me integrimin e plotë të ushtrisë malazeze në NATO, duke theksuar angazhimin e Ministrisë për modernizimin e sektorit të mbrojtjes. Ministri theksoi gatishmërinë e Malit të Zi për të mbështetur përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare në hartimin e stabilitetit, si një kontribut i Malit të Zi në sistemin kolektiv të sigurisë, por gjithashtu theksoi rëndësinë e angazhimit të ushtarëve malazezë jashtë vendit në përmirësimin e ndërveprimit dhe kapacitetit të ushtrisë.

Bashkëbiseduesit theksuan se bashkëpunimi aktual dypalësh midis Malit të Zi dhe Italisë në fushën e mbrojtjes është i një cilësie dhe përmbajtje të mirë, dhe u shprehën të kënaqur për suksesin e arritur në projekte me interes të përbashkët që lidhen me bashkëpunimin me

Bashkëpunim me forcat ajrore dhe detare italiane

Ministri i Mbrojtjes Predrag Boskoviç priti Atasheu Ushtarak të Italisë për Malin e Zi, mbi baza jorezidente, kolonel Ciro Forte



forcat ajrore dhe forcat detare të dy vendeve, si dhe për trainimin e kadetëve malazezë në akademitë ushtarake italiane.

Ndërkohë, kolonel Forte bisedoi edhe me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Malit

të Zi, gjeneral brigade Dragutin Dakic, Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë për Politikë dhe Planifikim të Mbrojtjes, Ivica Ivanoviç dhe Shefin e Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Diplomacinë Ushtarake, Andrei Latic.

Qeveria e Malit të Zi ka vendosur ngritjen e një poligoni në Sinjajevina për nevojat e ushtrisë malazeze. Ministri i Mbrojtjes, Predrag Boskoviç, tha se "poligoni që përdoret ekskluzivisht si një varg trajnimesh për ushtrinë, ka një sipërfaqe totale prej 74,596,381 m² dhe është shtrirë në tre komuna: Kolashin, Mojkovac dhe Savnik".

"Qeveria si një entitet përgjegjës ka vepruar për këtë çështje në mënyrën më të përgjegjshme të mundshme," tha Ministri Boskoviç.

Ministri thekson se "nuk është planifikuar shkatërrimi i armëve të tepërta, ushtria nuk do të ndërtojë asgjë atje dhe siguroi se kryerja e stërvitjeve nuk do të ketë ndikim në ndotjen e mjedisit". Këtë e dëshmon



Ministri i Mbrojtjes Predrag Boskoviç u takua me Ambasadorin e sapoemëruar të Republikës së Sllovenisë në Mal të Zi, Gregor Presker. Ata shkëmbyen mendime mbi situatën politike dhe të sigurisë në rajon dhe vunë në dukje nevojën për veprim të përbashkët dhe një përgjigje të unifikuar nga bashkësia ndërkombëtare për sfidat e ndërlikuara të sigurisë me të cilat përballet rajoni dhe Aleanca.

Boskoviç falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme të Republikës së Sllovenisë në arritjen e qëllimeve strategjike të politikës së jashtme të Malit të Zi dhe e njoftoi ambasadorin për procesin e reformave të sistemit të mbrojtjes, bashkëpunimin rajonal dhe përfshirjen e ushtrisë malazeze në misionet dhe operacione ndërkombëtare.

Ambasadori Presker tha se është i kënaqur me marrëdhëniet e jashtëzakonshme dypalëshe të dy vendeve në fushën e mbrojtjes, duke theksuar se përvoja e Malit të Zi, hyrja e saj në NATO dhe pozicioni i saj i shkëlqyeshëm në rrugën për në BE janë sukses fantastik, i vlefshëm për një rajon më të gjerë se Ballkani Perëndimor. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, e cila kontribuon shumë në stabilitetin e rajonit, duke theksuar se Mali i Zi mund të llogarisë në Slloveninë si një partner të

Sllovenia një partner i besueshëm në fushën e mbrojtjes



besueshëm në të gjitha fushat, dhe se takimi i sotëm është një mundësi e shkëlqyeshme për të përcaktuar drejtimet e intensifikimit të mëturjes në bashkëpunimit.

Bashkëbiseduesit diskutuan gjithashtu zhvillimet e tanishme politike në rajon dhe Evropë, si dhe

bashkëpunimin dypalësh midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, me theks të veçantë në bashkëpunimin e vazhdueshëm në kuadër të Prezencës së Avancuar të Përparme (eFP) në Letoni, si dhe forcimin e mëturjes në bashkëpunimit midis aviacionit dhe marinave të dy vendeve.

Sipërfaqe totale prej 74,596,381 m²

Poligoni ushtarak në Sinjajevina për nevojat e ushtrisë malazeze

edhe raporti për matjen e radioaktivitetit në mjedis (ajër, ujë, tokë), i cili është bërë për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë Veriore nga Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë Veriore në vendin e stërvitjes ushtarake Krivolak, pas një stërvitjeje një-mujore.

“Ajo që e bëri Qeverinë e Malit të Zi të vendosë të marrë një vendim të tillë është edhe fakti që ne kemi komunikuar me partnerët tanë në Bashkimin Evropian, vende me për-

vojë shumë më të madhe, njohuri dhe njohuri shumë më të mëdha kur bëhet fjalë për mbrojtjen e mjedisit. Në vitin 2000, si një dokument kryesor i BE-së për mbrojtjen e biodiversitetit dhe krijimin e një parku rajonal natyror, ai nuk është në kundërshtim me terrenet ushtarake,” tha Ministri Boskoviç. “Unë do të isha i pari që do të kundërshtoja dhe nuk do t'i bëja një argument të tillë Qeverisë nëse ekzistonte qoftë edhe një rrezik minimal për mjedisin e një mali siç është Sinjajevina me një veprimtari

të tillë.” Ai shtoi se qëllimi është që Sinjajevina të bëhet më mire për banorët që jetojnë atje, ashtu edhe për shumë turistë. Ministri kujtoi se, pasi u krijua Ministria e Mbrojtjes dhe Ushtria e Malit të Zi, testet ekotoksikologjike u kryen në disa lokacione në territorin e Malit të Zi. Gjithashtu është analizuar ndikimi mjedisor i shkatërrimit të municioneve në 2009 dhe 2010. Në raportet e Qendrës së Testimit Ekotoksikologjik të Malit të Zi thuhej se nuk kishte ndikim negativ dhe dëmtime mjedisore (ujë, ajri, natyra, toka, etj.). Bazuar në përvojën e kaluar dhe analizën e ekspertit, mund të konkludohet se municionet që do të përdoren gjatë kryerjes së ushtrimeve në malin Sinjajevina nuk mund të rrezikojnë mjedisin mbi asnjë bazë.

Jens Stoltenberg në OKB

NATO dhe Kombet e Bashkuara forcojnë njëra-tjetrën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg merr pjesë në Asambleenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg u bashkua me liderët e tjerë botërorë në New York më 23 shtator 2019, për të marrë pjesë në seancën e 74-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (UNGA).

Në margjinat e Asamblesë, Sekretari i Përgjithshëm u takua me Përfaqësuesin Special të SHBA për Pajtimin Afgan, Ambasadorin Khalilzad. Ata diskutuan situatën e sigurisë në Afganistan dhe mbështetjen e NATO-s për bisedimet e paqes. Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti takimet e rregullta të Ambasadorit Khalilzad për Këshillin e Atlantikut të Veriut. Ai theksoi se përqendrimi i NATO-s mbetet i pandryshuar: t'i bëjë forcat afgane të sigurisë, në mënyrë që ata të luftojnë terrorizmin ndërkombëtar dhe të krijojnë kushtet për paqe të qëndrueshme.

Më 24 shtator, Sekretari i Përgjithshëm mori pjesë në hapjen e Debatit të Përgjithshëm të KB. NATO dhe Kombet e Bashkuara forcojnë njëra-tjetrën, si organizata të përkushtuara për të trajtuar sfidat e sigurisë dhe për të mbështetur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Gjatë dekadës së fundit, të dy organizatat kanë rritur bashkëpunimin, duke punuar ngushtë për të mbështetur Afganistanin dhe Irakun. NATO gjithashtu ka kontribuar në zhvillimin e standardeve të asgjësimit të KB për të kundërshtuar pajisjet e improvizuara shpërthyes, të cilat mbeten një nga kërcënimet më të mëdha për paqeruajtësit.

Më vonë të martën, (datë 24) Sekretari i Përgjithshëm u takua me Presidentin e Ukrainës Volodymyr Zelenskyy. Të dy krerët diskutuan ndihmën politike dhe praktike të NATO-s për Ukrainën, si dhe përgatitjet për vizitën e ardhshme të Këshillit të Atlantikut të Veriut në Ukrainë. Përmes dhjetë Fondeve të Mirëbesimit, Aleatët dhe partnerët e NATO-s janë zotuar me më shumë se dyzet milion euro për të mbështetur Ukrainën, në fusha të tilla si komanda dhe kontrolli, mbrojtja kibernetike dhe rehabilitimi mjekësor. Stoltenberg u takua gjithashtu me disa liderë botërorë dhe zyrtarë të nivelit të lartë. Gjatë udhëtimit të tij, Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg ka vizituar Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara West Point (25 shtator), dhe ka mbajtur një fjalim në Universitetin Columbia (26 shtator 2019).



Në kuadrin e 85 vjetorit të lindjes

Shahin Leka me kontribute në fushën e studimit të Artit Ushtarak

Prof.Asoc.Dr.Bernard Zotaj

Rrënjët familjare

Profesor Shahin Leka Ka lindur në Delvinë më 2 tetor 1934 në një familje me tradita atdhetare. Gjyshi nga babai quhej Shahin Leka, emrin e të cilit e trashëgoi Shahini, ka shërbyer në Perandorinë Osmane me gradën ushtarake bimbash (major) në krahinat e Shqipërisë së Jugut. Gjyshi i tij vlerësohej për ndershmërinë, trimërinë, gjykimin e mënçur e të drejtë dhe gëzonte në popull respekt e autoritet të veçantë. Vdekja e parakohshme në vitin 1902, ia hoqi mundësinë për të marrë pjesë në ngjarjet e vullshme patriotike e luftarake të viteve 1900-1912. Gjyshi nga nëna Mehdi Hila, pasi mbaroi studimet për drejtësi në Stamboll e punoi për disa vjet si gjykatës e komisar i policisë së Stambollit. U kthye në atdhe dhe mori pjesë në shpalljen e pavarësisë në Vlorë më 28 nëntor 1912, përkrah Ismail Qemalit dhe atdhetarëve të tjerë. Në qeverinë e Ismail Qemalit u emërua në detyrën e drejtorit dhe prekurorit të çështjeve juridike. Babai i Shahinit, Mahmut Leka, mbaroi shkollën e mesme e mandej shkollën administrative dy vjeçare për përgatitje nëpunësish. Punoi si sekretar i parë i nënprefekturave në Delvinë, Bilisht, Libohovë, Himarë, Sarandë etj. Ai vlerësohej për korrektësinë, ndershmërinë e shpirtin njerëzor: Në verën e vitit 1942, duke mos pranuar të bëhej anëtar i partisë Fashiste, largohet nga puna. Familja u vendos në fshatin Vermero, disa kilometra larg Sarandës ku kishin çiflikun e tyre. Nëna Yfete Leka (Hila) e rritur në një mjedis arsimdashës mbaron shkollën fillore në vitet '20-të. Më vonë kryen në Elbasan një kurs një vjeçar për arsimtare.

Shkollimi dhe puna pedagogjike në shkencën ushtarake

Shahini shkollën fillore dhe 7-vjeçare e ka kryer në Sarandë dhe Tiranë. Në përfundimin e vitit të parë të gjimnazit "Qemal Stafa" në vitin 1951, shkon në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" ku mbaroi klasën e dytë. Gjatë viteve 1952-1954 përfundon me rezultate mjaft të mira kursin e gjuhëve të huaja, në gjuhën angleze në shkollën e Bashkuar të Oficerave dhe gradohet nëntoger. Krahas studimeve ushtarake gjatë këtyre viteve përfundon edhe dy vitet e tjerë të shkollës së mesme. Gjatë vitit 1955-1956 përsëri në Shkollën e Bashkuar përfundon një kurs për zbulimin ushtarak. Me përfundimin e kursit transferohet në Ersekë me detyrën e shefit të zbulimit

të batalionit autonom. Në pranverën e vitit 1957 emërohet komandant i Grupit të Zbulimit në Detashmentin e Zbulimit në Tiranë. Gjatë viteve 1958-1962 përfundon me korispondencë Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin shtetëror të Tiranës. Në vitin 1962 e transferojnë nga repartet e zbulimit në shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" në detyrën e komandantit të kompanisë.

Në shtator të vitit 1964, me gradën Kapiten i Parë, dërgohet për studime në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm (sot AFA) të cilën e përfundon me rezultate shumë të mira në dhjetor 1966. Me mbarimin e studimeve emërohet pedagog pranë kësaj akademie. Filloi për të një periudhë e gjatë mbi 25 vjeçare në fushën e pedagogjisë e të shkencës ushtarake. Për 9 vjet rresht 1966-1975 kreu detyrën e pedagogut të zbulimit e të ushtrive të huaja. Në vitet 1975-1977 kreu detyrën e pedagogut të historisë ushtarake. Me krijimin e katedrës së Historisë Ushtarake, të Zbulimit dhe të Ushtrive



të Huaja, u emërua përgjegjës i saj. Në mesin e vitit 1980 emërohet shef i Degës së Studimit të Artit Ushtarak dhe të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ndërsa me shkrijen e sektorit shkencor të akademisë në shtator të vitit 1984, emërohet shef i katedrës të Historisë Ushtarake, detyrë të cilën e mbajti deri në korrik 1992, kur doli në pension. Në korrik të vitit 1991 me rivendosjen e gradave në ushtri u gradua kolonel. Si pedagog dhe drejtues i katedrës së Historisë Ushtarake është përpjekur të ngrejë lëndën e historisë ushtarake në baza të shëndosha shkencore e nëpërmjet përsosjes dhe zgjerimit të saj në sasi dhe cilësi. Ndryshime të thella u bënë në këtë lëndë vitin 1977 e në 2-3 vitet në vijim, nëpërmjet hartimit të një programi me rreth 200 orë që zinte rreth 7% të programit të

përgjithshëm që bëhej në akademi. Për të siguruar këtë program u përgatitëm një numër i konsiderueshëm ligjirata, materiale, studime, dispenca e tekste mësimore duke sjellë informacion të ri, e duke shënuar hapa të rëndësishëm përpara në pikëpamje të metodologjisë e të strukturës, si dhe të thellimit të karakteri përgjithësues e të një analize më të mirë të problemeve në fushën e artit ushtarak.

Kryetar i shoqatës së historianëve ushtarak

Edhe pas daljes në pension nuk e ndërpreu veprimtarinë pedagogjike, studimore e shkencore. Si pedagog i jashtëm,

ka vijuar të zhvillojë mësim në Akademinë e Mbrojtjes dhe në Akademinë Ushtarake "Skënderbej". Deri në vitin 1995 ka qenë anëtar i këshillit shkencor të Akademisë dhe është aktivizuar si kryetar apo anëtarë në disa juri shkencore për mbrojtje disertacionesh. Për një periudhë rreth 20 vjeçare ka qenë anëtar i Kolegjit të Revistës "Për mbrojtjen e Atdheut", organ i MMP. Në nëntor të 1992, në krye të një grupi nismëtarësh filluam punën për krijimin e Shoqatës së Historianëve Ushtarake të Shqipërisë. Konferenca Kombëtare e shoqatës e mbajtur më 22 janar 1994 e zgjodhi kryetar të saj, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në vitin 2008. Si anëtarë i disa redaksive dhe këshillave shkencore, ka dhënë ndihmesë për organizimin dhe zhvillimin e konferencave e të sesioneve shkencore në bazë ushtrie e akademie, të të cilat ka mbajtur mjaft referate e kumtesa. Ka marrë pjesë në disa kongrese e konferenca shkencore ndërkombëtare si në Greqi, Bullgari, Rumani, Marok etj., ku dhe ka referuar. Në vitin 1985 mbrojti gradën shkencore "kandidat i shkencave", në vitin 1987 fitoi titullin "Docent", në vitin 1993 "Doktor i shkencave" dhe në janar të vitit 1995 fitoi titullin "Profesor". Ai zotëron tri gjuhë të huaja, anglisht, rusisht dhe italisht.

Veprimtari të pasur me studime pedagogjike e shkencore

Gjatë një periudhe 45 vjeçare me studime pedagogjike e shkencore ka pasur një veprimtari botuese të pasur, me një tematikë të gjerë e të larmishme që përfshin të gjitha periudhat e shoqërisë njerëzore kryesisht në fushën e historisë ushtarake, por edhe të teorisë ushtarake.

Ka botuar librat: "Historia e Artit Ushtarak Botëror" (bashkëautor), Ministria e Mbrojtjes, 1987, 531 faqe. Në këtë libër me 14 krerë, autorët Shahin Leka dhe Ibrahim Pajova trajtojnë zhvillimin e artit ushtarak nga lashtësia e deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore. "Historia e Artit Ushtarak të LANÇ-it të popullit shqiptar (bashkëautor dhe bashkëredaktor përgjigjës), Ministria e Mbrojtjes, Tiranë, 1989, 352 faqe. Ky libër ka 16 krerë, i ndarë në tri pjesë që u përgjigjen tri fazave të LANÇ-it, është përgatitur nga Dega e Studimit të Artit Ushtarak të LANÇ-it. "Skënderbeu, strateg dhe komandant legjendar", Shtëpia Botuese e ushtrisë, Tiranë, 1994, 210 faqe. Libri në trajtesën e një monografie me 8 krerë, është botimi i parë në të cilën Skënderbeu analizohet nën këndvështrimin e artit ushtarak si një strateg dhe komandant i përmasave të mëdha. "Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH (1943-1945)", Shtëpia Botuese "Flad", Tiranë, 1998, 200 faqe. Kjo monografi e përbërë nga 6 krerë është evidenton vlerat dhe rolin e rëndësishëm të Shtabit të Përgjithshëm për organizimin e UNÇSH-së dhe udhëheqjen e veprimtarisë së saj luftarake e të luftës së armatosur në tërësi. "Historia e Artit Ushtarak shqiptar nga lashtësia deri më 1939" (bashkëautor), Akademia e Mbrojtjes, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 2001, 368 faqe. Libri me 32 krerë është ndarë në 5 pjesë. Pjesa e katërt me 4 krerë trajton çështjet e artit ushtarak nga kohët e lashta të rendit patriakal e deri në shek. XIV. Pjesa e dytë me 8 krerë trajton artin ushtarak nën udhëheqjen e Skënderbeut. Dy krerë e pjesës së tretë trajtojnë çështje e artit ushtarak në kryengritjet e popullit shqiptar kundër sundimit Osman dhe të Pashallëqeve të Mëdha shqiptare. Pjesa e katërt me 3 krerë trajton artin ushtarak gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare (1830-1912). Pjesa e pestë trajton problemet e mprehta që lindën në fushën ushtarake për mbrojtjen e shtetit të pavarur shqiptar gjatë viteve 1912-1939. "Çështje të strategjisë ushtarake" (bashkëautor), Ministria e Mbrojtjes, Tiranë, 2002, 368 faqe. Libri përbëhet nga 12 krerë. Dy krerë e parë të shkruar nga Ruzhdi Ramadani, analizohen bazat e teorisë dhe të strategjisë ushtarake. Pesë krerë të shkruara nga Shahin Leka u kushtohen rrugës në të cilën ka ecur zhvillimi i strategjisë ushtarake dhe mendimit ushtarak nga lashtësia e deri në ditë tona. Objekt studimi në këtë krerë është historia e zhvillimit të shtabe. Në pesë krerë të tjerë të shkruara nga Pjetër

Marku, analizohen kushtet gjeografike që ndikuan në krijim e NATO-s, çështje të mundësive jo ushtarake të sigurimit, mundësitë dhe kufizimet e strategjisë kombëtare, institucionet evropiane të sigurisë e çështje të strategjisë asnjansë. "Historia e Artit Ushtarak Botëror në një këndvështrim të ri", mundësuar për botim nga Ministria e Mbrojtjes rreth 300 faqe. Libri analizon zhvillimet e artit ushtarak nga lashtësia deri në Luftën e Dytë Botërore. Ai është mbështetur në një fond të konsiderueshëm të literaturës çka përbën një risi të re në fushën e historisë ushtarake.

Në kuadrin e procesit mësimor dhe punës studimore shkencore në akademi ka përgatitur dhe shkruar disa studime për periudhën e luftës së popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut, për Luftën e Vlorës, analiza për strategjinë dhe operacionet gjatë LANÇ-it. Thyerja e mësymjes së përgjithshme të armikut në dimrin 1943-1944 (tema e disertacionit), si dhe një cikël leksionesh e metodikash për lëndët e zbulimit ushtarak, të ushtrive të huaja e të historisë ushtarake që kapin gjithsejt rreth 2100 faqe.

Nga numri i madh i referateve të mbajtura në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, po përmendim disa: Lufta e armatosur faktor kryesor për fitoren dhe ruajtjen e pavarësisë së shtetit shqiptar 1832-1920; Probleme të artit ushtarak në Luftën e Vlorës të vitit 1920; Pse kërkohet inkuadrimi në NATO; Vështrim në politikën dhe strategjinë e Lëvizjes Kombëtare shqiptare ndaj periudhave ndërluftuese në Luftën e Parë Ballkanike 1912-1913; Shqipëria dhe Lufta Italo-Greke; NATO, UÇK dhe Shqipëria në Luftën e Kosovës; Çështje të bashkëveprimit të UNÇSH me misionet aleate britanike gjatë Luftës së Dytë Botërore; Shqipëria në planet gjeostrategjike gjatë gjysmës së parë të shek. XX; Shtypi dhe botimet për Shqipërinë dhe shqiptarët gjatë shek. XX dhe ndikimi i tyre në luftërat dhe faktorët ushtarak; Ndërvartësia ndërmjet faktorit ekonomik dhe ushtarak në dy konfliktet e mëdha botërore të shek. XX, krahasime dhe përfundime; Çështje të strategjisë ushtarake të LANÇ-it; Synimet gjeostrategjike të pushtuesëve nazifashistë ndaj Shqipërisë në Luftën e Dytë Botërore etj.

Vlerësuar më çmim të Republikës dhe kontribues enciklopedik

Objekt trajtuese janë bërë problem të tilla si roli dhe funksionet e Këshillit të Mbrojtjes, funksioni i komandantit të Përgjithshëm, çështje të reformës në ushtri, çështje të strategjisë së LANÇ-it e të bashkëveprimit me aleatët e mjaft të tjera. Interes ka ngjallur analiza e disa problemeve me ndjesi shoqërore si revolta popullore dhe shpërbërja e ushtrisë në vitin 1997, kushtet për anëtarësim në NATO, një shikim retrospektiv në monarkinë e mbretit Zog, debat me zonjën Nexhije Hoxha për librin miqësi e tradhëtar, etj. Në një bllok me rreth 20 shënime botuar në revista shkencore dhe në shtypin e kohës ka trajtuar problem të luftës dhe zhvillimeve në Kosovë nëpërmjet analizës të rolit të UÇK-së dhe luftës së armatosur, strategjisë së NATO-s për çlirimin e Kosovës, Kosova në rrjedhat e gjeopolitikës, stabiliteti dhe siguria në Kosovë etj. Ka dhënë një ndihmesë në përgatitjen e Fjalorit Enciklopedik shqiptar, Fjalorit Enciklopedik ushtarak në fushën e historisë ushtarake, si dhe ka hartuar një numër zërash. Ka dhënë kontribut në Fjalorin Enciklopedik shqiptar botim i vitit 2008, duke qenë anëtar i redaksisë së fushës së Mbrojtjes, Rendit dhe Historisë Ushtarake për përgatitjen e Enciklopedisë Shqiptare (10 vëllimshe). Është përfshirë në botime të kontribuesit enciklopedik të QH të Kembrixhit dhe të Institutit Amerikan të Biografive. Mban medalje ushtarake (dekorata) akorduar nga Kuvendi Popullor dhe vendimin e Këshillit të Ministrave datë 15 nëntor 1989, për çmim të Republikës të shkallës së dytë për përgatitjen me cilësi të librit të HAU të LANÇ-it. Është i martuar në vitin 1962 me Dhimitra Koroveshin, e cila ka përfunduar studimet për mjekësi në Tiranë dhe ka kanë dy vajza të cilat kanë mbaruar studimet e larta universitare dhe punojnë në sektorë të ndryshëm me ndershmeri dhe përkushtim.

Me rastin e 90 vjetorit të lindjes Një jetë mes dallgëve

Kushtuar detarit nga Dhërmiu, Vasil V. Bixhili

NGA LEONARD BIXHILI*

Megjithëse i mbushi të nëntëdhjetat, mbahet shumë mirë falë një regjimi rigoroz, siç na thotë e bija Veronika me të cilën banon kohët e fundit, mbasi ka 7 vjet që ka humbur bashkëshorten. Në bisedë me të do konstatosh se ka një kujtesë dhe llogjikë të mprehtë. Fillon e tregon me saktësi e përpikmëri vënde, ngjarje dhe data nga historia interesante e jetës së tij. Unë mundohem të mbajë ca shënime shpejt e shpejt por ai në rrëfimet e tij "nuk kapet". I ngjan një lumi të pashtershëm që vazhdimisht shkon me rrëmbim, shpesh duke marrë me vete ç'të gjejë përpara.

Njëriut në jetë i duhet të përballet me dallgët e saj. Shpesh herë ndodh që kjo përballe fillon që në moshë të re, bile që fëmijë. Ky fat e ndoqi edhe barba Vasilin, por ndryshe nga të tjerët, atij i duhej përveç dallgëve të jetës, që nuk ishin pak, të përballej edhe me dallgët e deteve e oqeanëve për gati 43 vjet, si kryemekanik në anijet më të mëdha të flotës detare Shqiptare.

Barba Vasili u lind në 3 tetor 1929 në Dhërmi, një fshat i krahinës së Himarës në bregdetin Jonian. Familja e tij ishte një familja e varfër, e këputur. Prindërit e tij Vangjel dhe Kaliopi rropateshin gjithë ditën, nga mëngjesi në darkë, në punët e ndryshme bujqësore mbasi kishin për të ushqyer 7 fëmijë, nga të cilët më vonë vetëm 3 jetuan. Të tjerët vdiqën nga sëmundje të

ndryshme. Barba Vasili ishte më i madhi.

Në fshat mbaroi shkollën fillore dhe dy klasë greqisht. Që në moshë të njomë detyrohet të bëj lloj-lloj punësh për të ndihmuar prindërit, bile dhe si yzmeqar në familjet e tregtarëve të Vlorës. Kur ishte vetëm 14 vjeç, i frymëzuar nga dashuria për vëndin dhe urrejtjen për pushtuesin, vuri pushkën në krahë dhe doli partizan. Ai u inkadrua në batalionin e V-të të Brigadës së VI-të sulmuese "Heronië e Popullit", duke marrë pjesë në të gjitha luftimet e kësaj brigade, brënda vëndit por dhe jashtë kufinjve, në Jugosllavi e Mal të Zi.

"Në zbatim të urdhërit të Shtabit të Përgjithshëm të U.N.ÇI.SH. brigada jonë partizane-kujton barba Vasili, kaloi në zonat e veriut të vëndit. Marshimi drejt veriut u bë në luftë të pa ndërprerë, filluar nga Mirdita, Puka, Tropoja, Alpet, Dukagjin, Malsi e Madhe etj. Në një betejë të ashpër, në Shën Pal të Mirditës, përlëshja me armikun u bë trup me trup. Aty rrëmbeva, nga një gjerman i vvarë, pushkën dhe një pistoletë. Si fëmijë që isha i kisha qejf revolet dhe e kisha varur në brez, pa ditur se ajo ishte pistoletë shenjdhënëse.

Ishte nëntor i vitit 1944. Lufta u ndez e ashpër në lartësitë e maleve të Tropojës. Para betejës më thiri komisar i brigadës Haki Toska, i cili më kishte vënë nofkën "cirrok" dhe më tha:

"Ti i more gjermanit pistoletën shenjdhënëse. Atëhere me atë pistoletë, ti do japësh sinjalin për t'u hedhur në sulm".

Pikërisht, aty brigada jonë zhvilloi një nga betejat më të ashpra. N'atë betejë, nga shpërthimi i një bombe të fuqishme, u plagosa në kokë. Humba një pjesë të dëgjimit, bile atëhere dhe kujtesën. Koka më ishte mbushur me ciflat e bombës dhe më ishte ënjtur. Shpejt mblodha veten dhe në gjëndjen që isha mbusha pistoletën shenjdhënëse, por nga që fuqitë përsëri më kishin lënë, nuk munda ta mbaj lart. Presioni i gazrave e ktheu mbrapsht. Si pasojë, shkrepsti i armës m'u ngul në ballë duke më shkaktuar një plagë të dytë. Humba ndjenjat. Munda të dëgjoj vetëm zërin e partizanit Zemo Baboçi që



bërtiste: "u vra Vasili"... Më dërguan në spitalin partizan ku u mjekova gati një muaj.

Çlirimi më gjeti në Tuz të Malit të Zi. Ishte dimër i egër me temperatura mjaft të ulta. Bora arinte mbi një metër e gjysëm. Fizikisht isha shumë i dobët. Aty pësova ngrirje të gjithë trupit, komplet. Komandanti i kompanisë vajti dhe i tha komisarit se "cirroku" po vdes. Mbaj mend se më hypën në një mushkë dhe jam përmendur në ambjentet e spitalit të Shkodrës. Kur dola nga spitali vajta në komandën e korpusit dhe kërkova të kthehem në brigadën time, e cila vazhdonte luftimet në Jugosllavi. Tek po rija në një cep jashtë çadrës dhe prisja përgjigje, pashë me kuriz kthyer nga unë, Petro Markon i cili llafosej me komisarin. Nuk isha i sigurtë se ish ai prandaj iu afrova rojes dhe e pyeta:

"Kush është ai që po llafoset me komisarin dhe që po largohet"?

"Ai, më thotë roja, është një djal i ditur mor burr. Është nga jugu dhe ka luftuar në Spanjë. Meret me shkrime. Pjetër Marku e quajnë". E kuptova nga dialekti se roja ishte nga veriu. I bindur se s'kisha gabuar, i thira:

"Barba Petro - barba Petro"...! Ai u kthye menjëherë. Erdhi më përqafoi duke më thënë:

"Ç'bën këtu more Çili? (kështu më thërisnin në fshat). Para ca kohësh u ndodha në fshat. Erdhi mamaja jote dhe gjyshja dhe mu lutën: "Petro more djalë, ka ikur dhe Çili jonë partizan por nuk dimë gjë ku gjëndet. Ti që ke lidhje me ata të malit, pyet e mëso ku është. Është gjallë apo jo dhe na bëj haber".

U mallëngjeva shumë. Më shkuan lotë dhe rashë në prehërin e tij. I tregova historinë time. Më dëgjoji me vëmendje dhe më tha:

"Nuk mund të shkosh prapë në Jugosllavi. Sa dole nga spitali dhe je shumë i dobët dhe jo plotësisht i shëruar. Aty vazhdojnë ngricat, prandaj do t'u them këtyre shokëve të të dërgojnë diku gjetkë". Dhe kështu ndodhi. Me urdhër nga lartë më dërguan në garnizonin e Tiranës, si partizan roje në godinën e gazetës "Bashkimi". Aty hynin e dilnin figura të larta që unë s'i njihja, ndërsa barba Petron e shikoja pothuajse çdo ditë. Kaluan vitet. Unë, si djalë nga bregu, kisha një debulesë të madhe për detin. Këtë ja kisha shfaqur edhe barba Petros. Një ditë vjen e më thotë:

"Bisedova me Mehmet Shehun dhe do të dërgojmë në Bashkimin Sovjetik për të studjuar".

"Jo, jo - i thashë unë. Kam prindërit në fshat dhe kam kohë që s'i kam parë. Mezi pres që ti takoj. Nuk do ta durojnë dhe një ndarje tjetër".

"Atëhere ku do të shkosh"? - më pyeti.

"Dua të shkoj në Durrës e të bëhem detar" - i thashë.

U interesua menjëherë, foli me njëfarë Xhemal, që kishin bërë bashkë internimin në Itali dhe më dërgoi në Durrës. Kështu u ndodha për herë të parë në Durrës dhe më vonë u ngula aty".

Ishin vitet e para të mbas çlirimit. Me përpjekje të mëdha

filloi rimëkëmbja e vëndit. Po kështu po hidheshin hapat e para drejt themelimit të flotës detare. Gjatë kësaj kohe barba Vasili punon me një rimorkiator të vjetër. Në vitin 1947 shkon vullnetar në hekurudhën e parë Durrës-Peqin si komandant kompanie. Kur kthehet nga hekurudha me urdhër nga lart, e dërgojnë si kryetar grupi, mes 14 kolegëve të tjerë, në kurs për mekanik detar, në portin e Splitit në Kroaci, pastaj për një vit akoma në portin e Riekës, po të Kroacisë, por që atëhere ishin pjesë e Jugosllavisë. Prishja e marrëdhënieve me Jugosllavët e gjen duke bërë praktikën në portet Jugosllave.

"Një ditë, kujton barba Vasili, më thëret në zyrën e tij një oficer i lartë i flotës jugosllave dhe më thotë:

"Ty do të të mbajmë këtu. Do kesh një perspektivë të mirë mbasi do të dërgojmë përsëri në shkollë që të të jipet mundësia të bësh karrierë në flotën tonë detare. Në vëndin tuaj nuk ka shkolla". "Jo! Në asnjë mënyrë. Unë do të kthehem në vëndin tim. Ka Stalini shkolla për ne, i thashë dhe i hodha tutje një fletë që ma kish zgjatur për ta firmosur".

Kthehet në atdhe dhe emërohet drejtor i gjithë bazës mekanike detare në Durrës. Gjatë kësaj periudhe dekorohet nga Kuvëndi Popullor me dy dekorat pune dhe me "Urdhërin e Punës të klasit të tretë". Me kërkesën e tij kalon në prodhim dhe caktohet mekanik i parë në anijen "Partizani" ku punon gjashtë vjet. Pastaj për merita pune transferohet në anijen e parë trans oqeanike 12.000 tonëshe "Tirana", si kryemekanik. Me këtë anije ka çarë dete e oqeanë duke udhëtuar në shumë vënde si: Kubë, Gjermani Perëndimore, Marok, Bullgari, Rumani, Francë, Spanjë etj.

Mbas anijes "Tirana" transferohet në anijen "Vlora" si kryemekanik dhe më vonë në trans-oqeanikun "Shkodra" me të cilën ka udhëtuar në Kinë, Japoni, Kore etj. deri sa doli në pension në vitin 1989. Gjatë gjithë punës së tij i përballonte defektet në anije vetë, pa krijuar probleme e shqetësuar organet e larta. Ai si novator, në saj të përvojës së lartë dhe ndërgjagjes që e karakterizonte, i bënte vetë rimontet e makinerve dhe turbinave të anijeve. Barba Vasili mban sot: "Medaljen e Çlirimit të Atdheut", "Medaljen e trimërisë", "Urdhërin e Punës të klasit të tretë" dhe disa fletë lavdërime. Njëkohësisht ai ka: dëshminë e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe atë të invalidit.

Kjo është biografia e shkurtër e barba Vasilit, detarit nga Dhërmiu, që iku nga fshati në moshën 14 vjeçare dhe kur udhëtonte me anije e kalonte nga brigjet Joniane përsëhëndeste vëndin e tij duke i rënë sirenës, i djegur nga malli.

"Është Vasili jonë"-mbureshin bashkëfshatarët e tij dhe ngrinin dorën përjetë për ta përsëhëndetur nga largë e duke i uruar: "Rrugë të mbarë o djal i Dhërmiut"!

Sot, në përvjetorin e ditëlindjes, i urojmë: "Gëzuar ditëlindjen barba Vasili!

Edhe 100! ..Me shëndet të plotë dhe gëzime familjare, o bir i shquar i Dhërmiut"!

*Athinë, 3 tetor 2019



1931-2019: Refleksion për 88 vite aktivitet

Shtëpia e ushtarakëve në vite

Prof. Asoc. Dr. Bernard ZOTAJ
Dr. Asllan ZEMANI

Fillesat e institucionit

Shtëpia e Ushtarakëve është e lidhur ngushtësisht me ndryshimet dhe zhvillimet e Forcave të Armatosura. Fillesat e këtij institucioni i gjejmë me miratimin e dekret-ligjit të rregullimit të Ushtrisë Mbretërore Shqiptare, në vitin 1931, pas të cilit, efektivi i Ushtrisë mbërriti në kufijtë e 12.000 veta. Kjo strukturë e sapoformuar, u vendos e mori jetë në një ndërtesë krejt të veçantë në rrugën e Kavajës, e projektuar dhe e zbatuar nga inxhinieri i Armës së Xhenios të Ushtrisë Mbretërore Shqiptare, major Dhimitër Dhespoti. Në Shtëpinë e Oficerëve organizoheshin veprimtari të shumta kulturore-argëtuese, kryesisht për ushtarakët, por edhe ceremoni pritjeje të ndryshme protokollare, madje dhe ballo qeveritare e të ushtarakëve të lartë të Ushtrisë Mbretërore Shqiptare. Shefi i parë i Shtëpisë së Oficerëve ishte Kapiteni i Klasit I, Fehmi Poshi, oficer intendençe i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Kompleks me shërbime për ushtarakët

Pas çlirimit, në të njëjtën ndërtesë, më 14 Nëntor 1947, u përrua Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare dhe së bashku me hotel "Internacional" shërbente për ngrënien e fjetjen e oficerëve beqarë, lulishten në qendër dhe sallën 300 vende e kino-teatrit dhe më pas "Estradës së Ushtarit" (1952). Të gjitha këto përbënin një kompleks të plot shërbime për kohën, për të gjithë ushtarakët e Ushtrisë Shqiptare. Pararendëse e strukturës të "Shtëpisë Qendrore" ishte seksioni i Artit, në të cilën bënte pjesë Kori i Ushtrisë, Banda Frymore dhe Teatri, të cilët kishin kohë që filluar aktivitetin e tyre artistik e më pas, seksioni "Për shkollat dhe arsimimin", seksioni i "Prapavijës", Klubi Sportiv "Partizani" dhe Laboratori fotografik, i ardhur nga Shtypi Ushtarak. Kjo organikë e miratuar përbëhej nga rreth 130 veta, numër ky që, herë-herë rritej,

sepse në Korin e Ushtrisë përfshiheshin dhe ushtarë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Pjesë e misionit të këtij institucioni, për gati një dekadë rresht, krahas gjallërimit të jetës artistike në Ushtrinë Shqiptare nga grupet artistike ishte dhe dhënia e ndihmës së domosdoshme, të kualifikuar e konkrete nga të gjithë sektorët kundër analfabetizmit, që gati mbretëronte në radhët e Ushtrisë Shqiptare, si dhe arsimimi, kulturimi e mësimi i gjuhëve të huaja nga ana e oficerëve të sapo dalë nga lufta.

Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare

I vetmi grup artistik i këtyre viteve, "Kori i Ushtrisë" japte koncerte e shfaqje jo vetëm në "Shtëpinë e Oficerëve" por dhe kinematë qytetëse "Kosova" e "Nacional", duke plotësuar kërkesat e shumta, nga i gjithë populli i Tiranës, për të arritur në koncertin kulmues me këngë partizane, patriotike e popullore dhe në fund me



"Castadivën" e kënduar nga Tefta Tashko Koço. Turnetë artistike vijuan në aksionet e rinisë Kukës-Peshkopi, hekurudhën Durrës-Tiranë, kantierin e tharjes së kënetës në Maliq, Kanali "Naum Panxhi", por edhe në qytetet e Ohrit e më pas në atë të Shkupit për shqiptarët me banim në këto qytete së bashku me Grupin të Valleve 1947. Banda e Ushtrisë ishte prezente me koncertet e saj, në ceremoni e manifestime të panumërta, në përkujtimin e ngjarjeve historike kryesore, parada apo dhe në pritjet portokollare të Shtetit Shqiptar. Kjo trupë artistike profesioniste u kthye në furnizuese e të gjitha



institucioneve të tjera artistike shtetërore. Klubi sportiv "Partizani", pjesë e Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare dhe një ndihmesë të rëndësishme në organizimin dhe zhvillimin e lëvizjes fiskullore dhe sportive në Garnizonin e Tiranës dhe në reparte të tjera të Ushtrisë Shqiptare. Laboratori fotografik, si pjesë e propagandës figurative me vlera dokumentare artistike dhe edukuese për ushtrinë, filloi menjëherë aktivitetin me pasion e këmbëngulje duke grumbulluar negativët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të jetës partizane duke hedhur themelet e fondit arkivor.

Në dhjetor të vitit 1949, Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare përbëhej nga Ansambli i Këngëve dhe i Valles, Kori e Grupi i valleve; Seksioni i muzikës, Banda e Orkestra Simfonike; Theatri, Kinemaja, Seksioni i Arsimit, Biblioteka, Seksioni i Fiskulturës, skuadra e futbollit, basketbollit, volejbollit, atletikës së lehtë dhe të rëndë, shahu, noti e motiçiklumi; Seksioni i Shërbimeve dhe në përmblyllje e plotësonte, ai i ushqimit-social, pra Bufeja, e cila nga viti 1968, nuk u bë pjesë e kësaj strukture. E gjithë kjo strukturë përbëhej nga një efektiv me 253 veta, të cilët 13 ishin oficerë dhe 240 nëpunonjës civilë.

Qendër lëvizëse e agjitacionit në reparte e njësi

Tërësia e trupave, artistike, sportive, qendrat lëvizëse të agjitacionit në reparte e njësitë por dhe në stërvitjet e mëdha me trupa, për kohën, shtypi, shfaqjet e filmave kinematografikë, propaganda figurative e botimet e albumeve e fletë palosjeve, të përgatitura nga Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Popullore, (SHQUP) luajtën rol të rëndësishëm në edukimin ideo-artistik e sportiv jo vetëm për repartet e garnizonit të Tiranës, të Ushtrisë Shqiptare, por dhe në skenat e ambientet që qytetarë të shumtë ndiqnin aktivitetet, në kushtet e realitetit shqiptar të kohës. Nga kjo punë e organizuar dhe intensive në radhët e të rinjve, që kryenin dhe përfundonin shërbimet ushtarake, dolën mjaft artistë dhe sportistë të shquar në sferat e ndryshme të jetës e të mjeshtërisë fiskullore dhe sportive. Në vitet '50-'60 të shek. XX, pati ndryshime të ndjeshme në organikat e SHQUP-it, në 1958 u suprimua Teatri i Ushtrisë e një vit më pas, Klubi sportiv "Partizani, Ansambli i Ushtrisë dhe Banda e Ushtrisë u shpëputën nga ky institucion, për t'u rikthyer përsëri, këto dy të fundit, në vitin 1966. Në vitet 1962-1964, SHQUP-i u vendos në godinën e korpunit parlamentar dhe Akademisë së Shkencave, të

cilat shërbyen për zhvillimin e veprimtarive të shumta të organizuara nga ky institucion. Në këto ambiente ndodhej dhe biblioteka me rreth 20.000 tituj librash. Më pas, SHQUP-i u vendos përkohësisht në ambientet ku sot është Bankës Kombëtare Tregtare dhe salla për koncerte shërbeu godina që ndodhej mbas Komandës së Gardës. Në vitet '60 në SHQUP ndërvepronin, Sektori Metodik, i Kulturës, i Propagandës, i Krijimtarisë, Biblioteka dhe Dega e Mbështetjes.

Rol i rëndësishëm për zbatimin e misionit

Në tërësi këta sektorë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zbatimin e misionit që përçonte ky institucion nëpërmjet formave të ndryshme, për t'i bërë sa më efektive krijimtaritë në sferën e gjerë të propagandës, ndihmës metodike nëpër repartet, diafilmave me pamje nga stërvitjet e ndryshme, gatishmërisë, jetës ushtarake, përgjithsimet e përvojës së përparuar me botimet që prodhonte SHQUP-i etj. Një vend të rëndësishëm, zinte organizimi nga drejtuesit e edukimit, të vizitave e eskursioneve në fshatrat ku bëhej kolektivizimi, në aksionet ku ndërtoheshin hekurudhat, në hidrocentrale, takimet me shkrytarë të ndryshëm por edhe me të dalluarit në ushtri etj. Më 10 Korrik 1968 u përrua godina e re, pranë Urës së Lanës, tek rruga e Elbasanit, në të cilën u vendosën dy drejtori ndërvepruese, SHQUP-i në katin e dytë e në të parin, Drejtorja e Ushqimit-Social, që në zhargonin përditësor njihje si "Restoranti i SHQUP-it".



Në këtë qendër të re, ndodheshin dy salla, njera me 204 vende uljeje dhe skenë e tjetra me 50 vende, holli kryesor për vendosje ekspozitash tipologjike, si dhe për organizimin e homazheve për ushtarake e personalitete të tjerë shtetërore. "Shtëpia Qendrore e Oficerëve", mbante peshën kryesore të aktiviteteve të natyrave të ndryshme në shkallë ushtrie por edhe për aktivitetet e argëtimit me familjet dhe fëmijëve e ushtarakeve sidomos ditëve të shtuna, të diela dhe ditët festive. Vitet '70-'80, u shoqëruan me ndryshime strukturore të SHQUP-it, u suprimua sektori i krijimtarisë dhe sektori i prodhimit kinematografik, krijuar në 1967, i cili iu kalua Kinostudios "Shqipëria e Re", u formua sektori metodik, u bënë spastrime e seleksionime në fondin e bibliotekës. Në këtë periudhë, me rastin e përvjetorëve të shumtë të festave të ndryshme historike, aktivitetet e Orkestrës Frymore, Ansambli të Ushtrisë e Estrada e Ushtarit ishin të shumta. Krahas tyre, SHQUP-i or-

ganizonte shpërndarjen e shtypit, aktivitete kulturore, artistike, shfaqje filmash me pjesëmarrësit e paradave, stimuj moral, propagandimi të dalluarve, flatë-palosje të ndryshme, shfaqje të përbashkëta me intencionet artistike të Shtetit, të cilat rezultuan në 100 koncerte e shfaqje artistike, disa ekspozita fotografike, 60 shfaqje kinematografike në njësitë e repartet e Ushtrisë etj.

SHQUP-i organizoi edhe festivalin e filmit me tematikë për mbrojtjen, ekspozita fotografike me tematika: "Për mbrojtjen", emisione muziko-letrar e artistike, ligjërata "Pasqyrimi i mbrojtjes së atdheut në letërsinë artistike", diskutimet krijuese "Aktivitetet kulturore-artistike dhe lidhja e tyre me jetën, stërvitjen disiplinën dhe gatishmërinë në Ushtrinë Shqiptare" etj. Gjatë vitit 1985 Trupat artistike u shkëputën nga drejtimi i SHQUP-it dhe formuan komandë më vete e pas dy vitesh dhe Shkolla e Lirë Ushtarake e Kinostudios "Shqipëria e Re" me përjashtim të Komandës së Batalionit Artistik, që vijoi të qëndronte në vartësi të SHQUP-t. Trupat artistike të SHQUP-it, Ansambli i Ushtrisë, Orkestra Frymore dhe Estrada e Ushtrisë, si shkolla të para profesioniste të artit shqiptar, kryen një veprimtari të gjatë artistike në 50 vite, (1944-1994), duke dhënë 6000 koncerte si brenda, ashtu dhe jashtë Shqipërisë ndërsa, Sektori i prodhimit kinematografik, 1967-1974, prodhoi rreth 50 filma dokumentarë ushtarakë, propogandistikë dhe mësimorë.

Pasuri e rëndësishme kombëtare

Që nga viti i krijimit të SHQUP-it e në vijimësi, ndryshimet që ajo ka pësuar në strukturën e saj, janë të lidhura ngushtë me domosdoshmërinë e realizimit sa më të mirë të misionit të këtij institucioni. Struktura organizative dhe organika që ka patur kjo pasuri e rëndësishme kombëtare, mesatarisht ndërvite, ka rezultuar me një personel prej rreth 200 veta. Reformave të shumta në Forcat e Armatosura në vitet '90 e më pas, përfshinë edhe institucionin e Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë, e cila qysh në fillim, me rikonceptimin e misionit të saj, pësoi ndryshime jo vetëm emërtimet e saj të herë pas herëshme por u shoqëruan edhe shkurtime në strukturë e personel. Ndërkohë u rivendosën gradat ushtarake, u hoq funksioni i komisarit politik dhe i sekretarit të partisë e vendos ligji i depolitizimit dhe i departizimit të institucionit.

Pas kalimit në Qendër të Kulturës së Ushtrisë 1992, u riorganizua Ansambli i Ushtrisë dhe i Estradës së Ushtarit" ('93) e u ringrit Grupi artistik që sëbashku me Orkestrën frymore të Ushtrisë, vijuan aktivitetet e tyre nëpër repartet e ndryshme të Ushtrisë Shqiptare por edhe në stërvitjet e përbashkëta të zhvilluara në kuadrin e Marrëveshjes për Partneritetin për Paqe, koncerte për forcat shumëkombëshe që erdhën në Shqipëri në 1997 etj.

Në përbërje të këtij institucioni, (administrata, biblioteka, grupi artistik, orkestra frymore; 86 veta) u përfshi edhe Qendra e Foto-Filmit të Ushtrisë ('97), e cila fuqizua me aparatura televizive ('93) duke prodhuar rreth 20 filma dokumentarë dhe një numër i madh



kronikash televizive duke konkuruar edhe në Festivalin Ndërkombëtar të filmit ushtarak në Rumani i vlerësuar me "Çmim special".

Institucion me emërtim të ri

Në dekadën e parë të Shekullit të Ri, të përgatitjes dhe futjes në NATO, institucioni, tashmë me emërtimin e ri "Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes", ashtu si dhe FASH-i pësuan ndryshime thelbësore, qysh nga misioni i saj, i cili përcaktonte: "Informimi i qytetarëve dhe efektivave të Forcave të Armatosura të RSH-së, mbi aktivitetin që zhvillojnë këto forca, operacionet e tyre në kohë paqe, në konflikt apo luftë, edukimi i efektivave të FA-së me ndjenjat e patriotizmit, virtytet qytetare si dhe vlerat e lirisë e demokracisë". Bashkëpunimi e përafrimi me strukturat e NATO ndikuan dhe në riorganizimin e "Qendrës së Kulturës Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes", i cili u ngrit në nivel drejtorie, si e Marrëdhënieve me Publikun dhe informim, Drejtoria e publikimeve, Drejtoria e Aktiviteteve dhe Marrëdhënieve me komunitetin, Drejtoria e Aktiviteteve Sportive që rrokjin rreth 129 veta.

Me kalimin në strukturën e re organizative dhe vendosjen në planin e përhapjes të FARSH-it (2014) ky institucion mori emërtimin "Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes; Muzeu dhe Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve" me përbërje: Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve, Drejtoria e administratës dhe shërbimeve, Muzeu i FA-së dhe Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve me personel rreth 157 veta. Më pas, reduktimi i misionit sollën ndryshime edhe strukturorë (suprimimi i sektorit të marketingut, Shtëpive të Ushtarakëve, Shtëpive të Pushimit) me një personel prej 73 veta. Ky është rrugëtim i shkurtër në historinë e shtëpive të oficerave në vite.



BE ndihma për tërmetin



14 vende anëtare të Bashkimit Evropian si dhe 2 vende të tjera joanëtare u solidarizuan menjëherë për t'i ardhur në ndihmë familjeve shqiptare të prekura nga lëkundjet e tërmetit të datës 21 shtator 2019.

